

PROCESI I
“AXHENDËS
SË GJELBËR”

MANUAL
NACIONAL
ME PËRVOJAT E
AKTIVITETEVE
TË REALIZUARA
NË MAQEDONI



Procesi i “Axfordës së Gjellbër”

**Manual nacional
me përvojat e aktiviteteve të realizuara në Maqedoni**

Botues:

Milieukontakt International
Milieukontakt Interneshënëll – zyra lokale në Maqedoni

Për botuesin:

Igor Sllavkoski

Redaktorë:

Juliana Daskallov
Zharko Koneski
Maja Markovska
Aleksandra Karakashova Saçkarska

Fotografitë:

Nga arkivi i “Axfordës së Gjellbër” Maqedoni

Përktheu nga maqedonishtja në shqip:

Gazmend Qoku

Dizajni dhe kopertina:

Daniel Gjurginovski

Shtypi:

“Polyesterday”, Shkup

Publikimi u hartua në kuadër të Projektit “Forcat e bashkuara për ardhmëri të qëndrueshme në Ballkanin Perëndimor” (2006-2010), financiarisht u mbështet nga Programi rajonal për mbrojtje të mjedisit jetësor në Ballkanin Perëndimor të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës, ndërsa u koordinua nga Milieukontakt International nga Holanda. Në asnjë rast nuk mund të konsiderohet se ky publikim i pasqyron qëndrimet e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Holandës.

CIP – Katalogizimi në botim
Biblioteka Nacionale dhe Universitare
„Shën Klimenti i Ohrit”, Shkup

502.131.1(035)

PROCESI i “Axfordës së Gjellbër”: Manual nacional me përvojat nga aktivitetet e realizuara në Maqedoni/(redaktorë: Juliana Daskallov... etj.). – Shkup;
Milieukontakt International = Milieukontakt Interneshënëll, 2010. – fq. 102: tabela; 21 cm

ISBN 978-9989-2663-3-1

a) Одржлив развој - Прирачници
a) Zhvillimi i qëndrueshëm - Manuale

COBISS.MK-ID 85110282



Përmbajtja

”Akhenda e Gjellbër” – 17 hapa për ardhmëri të qëndrueshme	6
Modeli i partneritetit të mirë	10
Pasqyra e ”Akhendës së Gjellbër” në Maqedoni	12
Adresa	13
FAZAT E PROCESIT TË ”AXHENDËS SË GJELBËR”	15
Pasqyra e hapave të ”Akhendës së Gjellbër”	18
FAZA 1. Nisma dhe përgatitja.....	20
HAPI 1: PËRCAKTIMI I PALËVE TË INTERESUARA DHE ANALIZA E DOKUMENTEVE	23
FAZA 2: PËRGATITJET PËR PUNË NË KOMUNITET (NË GRUPE TË PUNËS) DHE MBLEDHJE TË RREGULLTA.....	25
HAPI 2: MBLEDHJA E PARË E PALËVE TË INTERESUARA.....	26
HAPI 3: Identifikimi i funksioneve të mjedisit jetësor	35
FAZA 3: ANALIZË E DETAJUAR E ÇËSHTJEVE KRYESORE	49
HAPI 4: TENDENCAT E FUNKSIONEVE TË MJEDISIT JETËSOR DHE EFEKTI I TENDENCAVE NË KOMUNITET.....	51
HAPI 5: EFEKTI I TENDENCAVE TË MJEDISIT JETËSOR	59
HAPI 6: KRIJIMI I VIZIONIT DHE VENDOSJA E STANDARDEVE MINIMALE	61
HAPI 7: PËRKUFIZIMI I PROBLEMEVE KRYESORE TË VLERAVE (MJEDISI JETËSOR)	67
HAPI 8: ANALIZA E SHKAQEVE TË PROBLEMEVE.....	72
HAPI 9: PËRKUFIZIMI I POTENCIALEVE DHE MUNDËSIVE	76
HAPI 10: PËRKUFIZIMI I POTENCIALEVE PRIORITARE DHE ZGJIDHJET	81
FAZA 4: SINTEZA DHE PLANIFIKIMI	92
HAPI 11 DHE 12: PËRKUFIZIMI I PLANIT STRATEGJIK NË KUADËR TË DOKUMENTIT ”AXHENDA E GJELBËR”	94
HAPI 13: PËRPILIMI I DOKUMENTIT	96
FAZA 5: MBIKËQYRJA (MONITORIMI) DHE VAZHDIMI	97
NDËRLIDHJA E ”AXHENDËS SË GJELBËR” ME LEGJISLACIONIN E MAQEDONISË.....	99



”Axfenda e Gjebër” – 17 hapa për ardhmëri të qëndrueshme

Koncepti i “Axfendës së Gjebër” për herë të parë u realizua në Rumuni nga “Milieukontakt” dhe nga partneri i tyre lokal “Fokus eko-qendra”. Koncepti e siguroi “Milieukontakt”-in se metoda e përdorur është një vegël e fuqishme, e cila mirëfilli mund të rezultojë ndryshime pozitive dhe afatgjate dhe vendin tonë ta shndërrojë në një vend më të mirë për jetesë. Ideja e implementimit të “Axfendës së Gjebër” rezultoi nga “Axfenda Lokale 21”, e cila u promovua në nivel global në Konferencën për Mjedis Jetësor dhe Zhvillim në Rio de Janeiro në vitin 1992. “Axfenda e Gjebër” fillon me përfshirjen e vlerave lokale dhe kulturore dhe fokusohet në përcaktimin e skenarëve fitues (win-win) për zhvillimin e qëndrueshëm lokal, duke i shfrytëzuar vlerat e identifikuarat. Në këto skenarë, para së gjithash, janë marrë në konsideratë faktorët natyrorë, ekonomikë dhe socialë.

“Axfenda e Gjebër” është metodë participuese në krijimin dhe implementimin e strategjive dhe planeve zhvillimore lokale, me inkuadrimin aktiv të sektorëve të ndryshëm të komunitetit lokal ku zbatohet procesi. Për dallim nga proceset e tjerë, të cilët kanë qëllim të ngjashëm, “Axfenda e Gjebër” ka së paku tri aspekte të reja në drejtim të realizimit të qëllimit të parashtruar: procesi fillon me identifikimin e vlerave lokale e jo me identifikimin e problemeve lokale; pjesëmarrja në proces nuk kufizohet vetëm në nivel ekspertësh ose në nivel të grupeve të caktuara, palë të interesuara, por është i hapur për të gjithë dhe si rezultat procesi është pronësi e popullsisë lokale.

Metoda

Nocioni “Axfordë e Gjelbër” përdoret edhe për procesin që i përfshin të gjitha grupet dhe sektorët në komunitetin lokal dhe në emër të dokumentit në të cilin janë shënuar të gjitha konkluzionet dhe planet e ardhshme. Qëllimi i “Axfordës së Gjelbër” është i dyfishtë: nga njëra anë është tejet i rëndësishëm procesi i participimit përmes së cilit mund të arrihet marrëveshje e përbashkët, komunikim dhe bashkëpunim; ndërkaq, nga ana tjetër është domethënia dhe rëndësia e rezultateve të procesit – Plan veprimi lokal, i cili mund të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm lokal dhe ta përmirësojë kualitetin e jetesës.

Metoda e “Axfordës së Gjelbër” është zhvilluar nga “Milieukontakt” para më shumë vitesh edhe atë në vende të ndryshme (Rumuni, Kroaci, Moldavi, Kirgistan), dhe përbëhet nga 17 hapa. Këto hapa koordinohen nga shoqatat (ekologjike) lokale të qytetarëve, ndërkaq për punën kryesore kujdesen grupet e punës që formohen në komunitetet lokale. Këto grupe të punës përbëhen nga përfaqësues të palëve të interesuara lokale-autoriteteve lokale, sipërmarrës lokalë, organizata joqeveritare (OJQ) dhe nënkuptohet nga qytetarë aktiv. OJQ-të dhe grupet lokale kanë mbështetje intensive nga trajnuesit dhe ekspertët lokalë dhe të huaj, si dhe nga “Milieukontakt” dhe nga personeli lokal.

Si ta realizojmë “Axfordën e Gjelbër” në komunitetin tonë?

Kjo është çështja kryesore mbi të cilën fokusohet ky Manual, të cilës përpiket t'i jep përgjigje të detajuar, duke përfshirë metoda konkrete, vegla dhe akses, si dhe shembuj nga realizimi i tre proceseve të përfunduara deri më tani të “Axfordës së Gjelbër” në Maqedoni.

Ky Manual është rezultat i një procesi të gjatë të mësimi përmes punës në zbatimin e “Axfordës së Gjelbër” në Maqedoni, në kuadër të projektit “Forca të përbashkëta për një ardhmëri të qëndrueshme në Ballkanin Perëndimor”, i financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Holandës. Duke nxjerrë mësim nga përvoja e shoqatave të qytetarëve dhe komuniteteve në Kroaci, ku paraprakisht përfundoi procesi, me kujdes të madh filluam me punë në tri komunitete në Maqedoni: Komunën Dellçevë, Komunën Manastir dhe Komunën Vevçan. Procesin në këto komunitete u drejtua nga organizatat tona partnere: Qendra Rajonale për Përfaqësim-Dellçevë, Qendra për Edukim dhe Mbrojtje të Natyrës “Biosfera”-Manastir dhe Njësia Vëzhguese “Kërste Jon” – Strugë. Në këto tri komunitete procesi u realizua tërësisht dhe i njëjti dha rezultate të dukshme që në fillimin e zbatimit të procesit, duke dëshmuar se “Axforda e Gjelbër” është një vegël e

shkëlqyeshme për promovimin dhe thellimin e bashkëpunimit ndërmjet të gjithë sektorëve në nivel lokal dhe njëkohësisht vegël e shkëlqyeshme për promovimin dhe ruajtjen e vlerave natyrore dhe kulturore të komuniteteve, duke siguruar parakushte për zhvillim dhe investime konkrete afatgjate.

Kjo përvojë kontribuoi që të rritet interesimi për zbatimin e “Axhendës së Gjelbër” dhe procesi të zgjerohet edhe në komunitetet tjera në Maqedoni. “Axhenda e Gjelbër” kishte mbështetje të gjerë nga ana e shumë institucioneve dhe organizatave, si dhe nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Maqedonisë. Dëshmi për suksesin e Programit janë dy projekte të reja të cilat paraqesin vazhdimin dhe zgjerimin e këtij Programi. Ky është Projekti “Partneriteti evropian për axhendat e gjelbra lokale”, i financuar nga “Programi për Ndihmë Paraaderuese të Komisionit Evropian (IPA)” dhe Projekti “Axhenda e Gjelbër si vegël për ruajtjen e vlerave natyrore dhe kulturore”, i financuar nga “Programi për investime në mjedisin jetësor” i Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Maqedonisë.

Për realizimin e suksesshëm të këtij Projekti meritë të madhe ka bashkëpunimi i shkëlqyeshëm me Fondin Ekologjik Global – “Programi për Grante të Vogla”, si dhe mbështetja e përgjithshme nga Zyra Qendrore e “Milieukontakt Interneshënël”-Amsterdam dhe nga koordinatori për Maqedoni, Rita van Keulen.

Kjo ishte edhe një nxitje për të filluar me hartimin e këtij Manuali, i cili ka për qëllim që të gjithë ata të cilët në një të ardhme do të kishin dashur të inkuadrohen në rrjetin e komuniteteve, të cilët kanë hartuar “Axhendë të Gjelbër” në Maqedoni dhe më gjerë, t’u mundësohet që me sukses ta zbatojnë procesin e “Axhendës së Gjelbër”. Ky Manual e përfshin procesin e përgjithshëm me të gjitha informatat e nevojshme për secilën fazë dhe për çdo hap të “Axhendës së Gjelbër”, duke i adaptuar përvojat ndërkombëtare me nevojat dhe kërkesat e komuniteteve në Maqedoni. Manuali bazohet në zbatimin e tri “Axhendave të Gjelbra” të para: në Dellçevë, Manastir dhe në Vevçan, përfshirë edhe përvojat e shembujve në cilat hasëm, por edhe vështirësitë dhe pengesat me të cilat u ballafaquam, si dhe mënyrat për tejkalimin e tyre.

Manuali u përgatit përmes punës dhe të gjithë ata të cilët ishin të përfshirë në procesin e zbatimit të “Axhendës së Gjelbër” në Maqedonisë kanë meritë të veçantë për hartimin e tij. Me këtë rast, në veçanti dëshiroj t’u shpreh falënderim të madh partnerëve/organizatave tona-Qendrës Rajonale për Përfaqësim nga Dellçeva; Njësisë Vëzhguese “Kërste Jon” nga Struga; Qendrës për Edukim dhe Mbrojtje të Natyrës “Biosfera” nga Manastiri; Platformës së “Axhendës së Gjelbër” në Maqedoni; Trupit

Këshillëdhënës të “Axfhendës së Gjelbër”, si dhe të gjithë atyre të cilët në mënyrë të drejtpërdrejt punuan në hartimin e Manualit: trajnuesit e “Milieukontakt Interneshënëll”- Juliana Daskallov dhe Zharko Koneski dhe anëtarët e Platformës së “Axfhendës së Gjelbër”-Aleksandra Karakashova Saçkarska dhe Maja Markovska.

Ky është Manuali i parë i këtij lloji i përgatitur ekskluzivisht për nevojat e “Axfhendës së Gjelbër” në Maqedoni dhe lirisht mund ta përdorë gjithsecili që ka dëshirë të inkuadrohet në “Axfhendën e Gjelbër”. Megjithatë, ky Manual duhet të zgjerohet në mënyrë permanente, të rritet dhe formësohet, të plotësohet me përvoja të reja dhe shembuj të rinj nga të gjitha “Axfhendat e Gjelbra” të reja, të cilat edhe më tej do të zbatohen në Maqedoni dhe do të duhej të rezultonte edhe me versione dhe edicione të reja. Pikërisht për këtë shkak, ky Manual është hartuar në version të shtypur dhe elektronik (ueb), gjë që mundëson me lehtësi të bëhet plotësimi dhe azhurnimi i tij me përmbajtje të reja.

Në fund, i dëshiroj proces të suksesshëm “Axfhendës së Gjelbër” dhe të gjithë atyre që kanë vendosur ta zbatojnë në komunitetin e tyre. Zyra e “Milieukontakt Interneshënëll” në Maqedoni, si dhe ekipi ynë i trajnuesve dhe bashkëpunëtorëve janë të hapur për bashkëpunim të mëtutjeshëm me qëllim të zgjerimit të procesit nëpër Maqedoni dhe zbatimit të tij më të lehtë.

Igor Sllavkoski,

Koordinator lokal i projektit për Maqedoni
“Milieukontakt Interneshënëll”
Zyra në Maqedoni



Modeli i partneritetit të mirë

Si udhëheqës i Fondit Global Ekologjik “Programi për Grante të Vogla” (FGE PGV) Maqedoni”, që në fillim u përfshiva në mënyrë të drejtpërdrejt në gjithë procesin demokratik dhe transparent të “Axhendës së Gjelbër”. Duke perceptuar se “Axhenda e Gjelbër” është ecuri edhe për banorët lokalë, FGE PGV u ofrua të inkuadrohet si partner në një pjesë të realizimit të disa aktiviteteve të zgjedhura, me qëllim që të arrihen rezultate të dukshme, të matshme dhe të qëndrueshme, të cilat popullsinë lokale do ta motivojnë të vazhdojë të veprojë në mënyrë pozitive, me ç’rast do të shërbejë si shembull dhe model për “Axhendat e Gjelbra” të tjera të njëpasnjëshme në Republikën e Maqedonisë.

I formuar në vitin 1992 në Samitin e Rio-s, “Programi për Grante të Vogla” të Fondit Global Ekologjik, e realizoi esencën e zhvillimit të qëndrueshëm. FGE PGV drejtpërsëdrejti e kanalizoi mbështetjen teknike dhe financiare drejt shoqatave të qytetarëve për aktivitetet me të cilat mbrohet dhe rigjenerohet mjedisi jetësor dhe njëherësh e përmirëson jetën dhe mirëqenien e popullsisë. PGV-ja, udhëhiqet nga qëndrimi se problemet globale ekologjike më së miri mund të përballen nëse në zgjidhjen e tyre inkuadrohen qytetarët e komuniteteve lokale, kur në mënyrë të drejtpërdrejt zhvillohet ndjenja e pronësisë nga komuniteti, kur ekzistojnë favore të drejtpërdrejta për të gjithë brenda komunitetit dhe më gjerë.

Duke e pasur parasysh se pjesëmarrja, fleksibiliteti dhe transparenca janë themele të qasjes tek FGE PGV edhe tek “Milieukontakt Interneshënël” u zhvillua partneriteti konstruktiv, me ç’rast shoqatat e qytetarëve paraqitën projekte për ndihmë financiare nga FGE PGV për zbatimin e aktiviteteve që rezultuan nga “Axhenda e Gjelbër”. Së këtejmi, në kuadër të Programit Operativ 4 Grant Viti 1 – 2007 FGE PGV Maqedoni dhe “Milieukontakt Interneshënël” nënshkruan Shkresën për bashkëfinancim paralel të

obligueshëm. FGE PGV ofroi 60 000\$, dedikuar për bashkëfinancimin e projekteve: “Vallë a nuk je i gjelbër”, të zbatuar nga Qendra Rajonale e Përfaqësimit, Dellçevë, dhe “Linja e gjelbër për ndërlihdje” të zbatuar nga Njësia Vëzhguese “Kërste Jon” nga Struga. Aktivitetet në Dellçevë rezultuan me atë që të reduktohet emetimi i CO2 dhe të kursehen mjete financiare për projektet e ardhshëm në nivel lokal, ndërkaq aktivitetet e “Kërste Jon” në Vevçan rezultuan me zhvillimin e turizmit alternativ lokal dhe me këtë edhe ruajtjen e diversitetit biologjik në këtë zonë.

Jam i sigurt se rezultatet e dukshme dhe të matshme të projektit do të bëhen model për partneritet të mirë në krijimin e “Axhendave të Gjelbra” të reja dhe do ta nxisin bashkëpunimin për pjesëmarrje të përbashkët financiare, e cila do të jetë e qëndrueshme falë motivimit të realizuesve dhe shfrytëzuesve në nivel lokal.

Mr. Zlatko Samarxhiev,
Koordinator nacional i programit
FGD PGV Maqedoni

Pasqyra e “Axfordës së Gjellbër” në Maqedoni

Në muajin shkurt të vitit 2007 filloi realizimi i Programit “Axforda e Gjellbër në Ballkanin Perëndimor”, të cilin e zbatojnë “Milieukontakt Interneshënëll” (Milieukontakt International) dhe 18 partnerë lokal në vendet e Ballkanit Perëndimor. Në Maqedoni tri organizata joqeveritare e zbatuan procesin e “Axfordës së Gjellbër”: Njësia Vëzhguese “Kërste Jon-Qendra e Gjellbër” – Strugë që u angazhua për procesin e “Axfordës së Gjellbër” në Komunën e Vevçanit, “Biosfera” e zbatoi procesin e “Axfordës së Gjellbër” në Komunën e Manastirit dhe, Qendra Rajonale për Përfaqësim punoi në zhvillimin e “Axfordës së Gjellbër” në Komunën e Dellçevës.

Në fillimet e zbatimit të procesit të “Axfordës së Gjellbër” në Maqedoni, Zyra lokale e “Milieukontakt Interneshënëll” nënshkroi Memorandum për mirëkuptim dhe bashkëfinancim me Fondin Global Ekologjik-Programin për Grante të Vogla (FGE PGV), kështu që mjetet financiare u rritën dhe rezultatet u bënë më të dukshme për banorët lokalë, gjë që e afirmoi procesin.

Hapat dhe fazat e procesit të “Axfordës së Gjellbër” kanë përfunduar, dokumentet lokale janë përpiluar dhe janë miratuar nga Këshillat e komunave Vevçan dhe Dellçevë, ndërsa në Komunën e Manastirit dokumenti është mbështetur nga ana e Këshillit të Komunës. Pilot-projektet, të cilët janë përkufizuar në bazë të prioritetëve të grupeve të punës, u realizuan në të gjitha komunat. Si rezultat i pilot-projekteve u arrit:

- Rikonstruksioni i burimeve të Vevçanit (ndriçim me drita efikase energjetike dhe ndërtim të vendvrotjimit) dhe formimi i “Qendrës Informative Turistike” në Vevçan;
- Në Dellçevë u zëvendësuan rreth 150 drita elektrike klasike për ndriçim rrugor me drita efikase energjetike-kandellabra, si dhe përpunimi i bedenit dekorues me lulishte në qendër të qytetit;
- Në kuadër të Projektit, në Manastir u hap zyrë për informata në lidhje me procesin e “Axfordës së Gjellbër” dhe Konventës së Arhusit. Lokali dhe shpenzimet e zyrës u siguruan nga pushteti lokal. “Axforda e Gjellbër” në Manastir bëri edhe një hap para dhe, përmes donacioneve nga persona të caktuar dhe nga pushteti lokal, formoi Qendrën Edukative-Informative “Volvoks”.

Gjatë zbatimit të procesit u detektua nevoja për një komunikim dhe bashkëpunim më të mirë ndërmjet organizatave që e implementojnë procesin e “Axhendës së Gjellbër” në Maqedoni, si dhe një bashkëpunim më të mirë ndërmjet organizatave dhe zyrës lokale të “Milieukontakt”.

Nevoja e promovimit në nivel nacional dhe shkëmbimi i përvojave u bënë të domosdoshme. Për këtë qëllim, në muajin maj të vitit 2008, u formua Platforma nacionale e “Axhendës së Gjellbër” si nismë e të tria organizatave të cilat e zbatuan procesin e “Axhendës së Gjellbër” në Maqedoni. Në vitin 2010 Platforma u shndërrua në shoqatë qytetare të pavarur “AXHENDA E GJELBËR” me seli në Shkup. Qëllimi strategjik i Platformës së “Axhendës së Gjellbër” në Maqedoni është që ta promovojë procesin në nivel nacional dhe të nxisë e josh komuna të reja për zbatimin e procesit.

Në kuadër të Projektit, në vitin 2009, u formua edhe Trupi Këshillëdhënës i “Axhendës së Gjellbër” të cilin e përbënin gjashtë persona të pavarur profesionistë nga institucione dhe organizata të ndryshme në Maqedoni, ku secili e përfaqëson fushën e vet.

Sot, këto tri organizata kanë një bashkëpunim të ngushtë dhe komunikim të mirë me të gjitha palët e interesuara dhe ndërmjet tyre vazhdimisht shkëmbejnë përvoja.

Adresa

Zyra Lokale e “Milieukontakt Interneshënëll” në Shkup, Maqedoni

Adresa:	“Ognjan Prica” nr. 1/4-23, 1000 Shkup
Tel/faks:	+ 389 2 3226 888
Personi për kontakt:	Igor Sllavkovski
Celulari:	+ 389 75 212 557
Adresa elektronike:	igor@mkoe.org.mk
Faqja e internetit:	http://www.greenagenda.net/macedonia/

Zyra Qendrore e “Milieukontakt Interneshënëll” në Amsterdam, Holandë

Adresa: Plantage Middenlaan 2d,
PO Box 18185
1001 ZB Amsterdam, the Netherlands

Telefoni: +31 20 531 8930

Persona për kontakt: Rita van Keulen r.vankeulen@milieukontakt.nl
Suzanne Bakker s.bakker@milieukontakt.nl

Faqja e internetit: <http://www.milieukontakt.nl>

Pasqyra e komunave dhe organizatave të cilat e zbatojnë “Axhendën e Gjelbër” në Maqedoni nga viti 2007 deri në vitin 2010

Komuna	Emërtimi i shoqatës së qytetarëve	Personi për kontakt	Telefoni:	e-mail
Manastir	“Biosfera” - Manastir	Neshad Azemovski	(047)234-973	biosfera@t-home.mk
Vevçan	NJV “Kërste Jon” - Qendra e Gjelbër, Strugë	Maja Markovska	(046)783-173	13.maja@gmail.com
Dellçevë	“Qendra Rajonale për Përfaqësim” - (QRP), Dellçevë	Toni Stoimenovski	(033)411-727	tstoimenovski@sonet.com.mk

FAZAT E PROCESIT TË “AXHENDËS SË GJELBËR”

Procesi “Akhenda e Gjëlber” është proces ciklik: pasi të përfundojë, përsëri mund të nis nga fillimi. Në bazë të rezultateve të rrethit të parë, mund të fillojë rrethi i dytë, në të cilin do të zgjidhen problemet e reja ose do të gjenden zgjidhje të reja të cilat paraprakisht nuk kanë mundur të zgjidhen me sukses. Në këtë kontekst, “Akhenda e Gjëlber” është një proces i gjallë dhe dinamik, i cili nuk duhet të përfundojë vetëm si dokument ose me aktivitete të pakta.

Megjithatë, çdo rreth i procesit ka fillim dhe fund të qartë. Prosesi i përgjithshëm i “Akhendës së Gjëlber” mund të ndahet në pesë faza të zbatimit. Çdonjëra nga këto faza ka objektiva të ndryshme, me ç’rast nevojiten aktivitete të ndryshme në mënyrë që të mund të arrihen ato objektiva. Më poshtë janë dhënë pasqyrat skematike të fazave.

Metoda për strukturimin e aktiviteteve të quajtura ASMJ (Analiza Strategjike e Mjedisit Jetësor)

FAZA 1

NISMA DHE PËRGATITJET

Të përgatitet dhe organizohet procesi.

FAZA 2

PËRGATITJA E PUNËS NË KOMUNITET (NË GRUPE TË PUNËS) DHE MBLEDHJE TË RREGULLTA

Të përfshihen njohuritë ekzistuese, të përcaktohen çështjet kryesore dhe mangësitë.

FAZA 3

ANALIZË E DETAJUAR E ÇËSHTJEVE KRYESORE

Të analizohen çështjet kryesore (problemet, zgjidhjet, alternativat etj.) për çdo sektor, për grupet sociale ose për zonat.

FAZA 4

SINTEZA DHE PLANIFIKIMI

Të përkufizohet vizioni dhe kriteret strategjike

FAZA 5

MBIKËQYRJA (MONITORIMI) DHE VAZHDIMI

Të mbështetet vazhdimi përmes mbikëqyrjes, pronësisë, ngritjes së kapaciteteve dhe ngjashëm.

Hapat paraqesin strukturë logjike:

Hapat 1 – 4 fokusohen në analizën e kontaktit lokal dhe kontaktit më të gjerë ndërmjet shoqërisë dhe mjedisit jetësor.

Hapat 5 dhe 6 fokusohen në analizën e përcaktimit dhe në analizën e problemeve ekologjike.

Hapat 7 dhe 8 fokusohen në mundësitë ekzistuese (operative dhe strukturale).

Hapat 9 dhe 10 fokusohen në krijimin e vizionit dhe të potencialeve me prioritet dhe zgjidhjet.

Hapat 11 – 13 përqendrohen në përcaktimin e planit strategjik në kuadër të dokumentit të “Axhendës së Gjelbër”, zhvillimin e planit të monitorimit dhe finalizimin e dokumentit të “Axhendës së Gjelbër”;

Hapi 14 fokusohet në miratimin e dokumentit të “Axhendës së Gjelbër”, në monitorim dhe në zbatimin e vazhdimin (pilot-projekte).

Tabela e fazave dhe hapat e “Axfhendës së Gjellbër”

Analiza e mjedisit jetësor – konteksti shoqëror	Hapi 1: Përcaktimi i palëve të interesuara		
	Hapi 2: Mbledhja e parë e palëve të interesuara		
	Hapi 3: Përcaktimi i funksioneve të mjedisit jetësor (vlerave).		
	Hapi 4: tendencat e funksioneve të mjedisit jetësorë (vlerave).		
Analiza e problemeve ekologjike	Hapi 5: Efekti i tendencave të mjedisit jetësor	Hapi 7: Përkufizimi i problemeve kryesore të mjedisit jetësor	Analiza e mundësive ekologjike
	Hapi 6: Krijimi i vizionit dhe vendosja e standardeve minimale	Hapi 8: Analiza e shkaqeve të problemeve	
Planifikimi strategjik dhe monitorimi	Hapi 9: Përkufizimi i potencialeve dhe mundësive		
	Hapi 10: Përkufizimi i potencialeve prioritare dhe zgjidhjet		
	Hapat 11-13: Përkufizimi i Planit Strategjik në kuadër të dokumentit “Axfhenda e Gjellbër”.		
	Hapi 14: Miratimi i dokumentit “Axfhenda e Gjellbër”, monitorimi dhe vazhdimi (pilot-projektet)		

Pasqyra e hapave të “Axfordës së Gjellbër”

Tabela e kohëzgjatjes së hapave të procesit të “Axfordës së Gjellbër”

Hapi	Përshkrimi	Dokumenti	Afati kohor
OJQ	Përcaktimi i palëve të interesuara dhe analiza e dokumenteve.		2 javë
OJQ	Mbledhja e parë me palët e interesuara.		
Grupet e punës	Funksionet e mjedisit jetësor.		2 mbledhje
Grupet e punës	Tendenat e funksioneve të mjedisit jetësor dhe efektet nga të njëjtat.		2-3 mbledhje
Grupet e punës	Krijimi i vizionit dhe vendosja e standardeve.		3 mbledhje
Grupet e punës	Përkufizimi i problemeve kryesore të mjedisit jetësor		4 mbledhje
Grupet e punës	Analiza e shkaqeve të problemeve.		2 mbledhje
Grupet e punës	Përkufizimi i potencialeve dhe mundësive.		3 mbledhje
Grupet e punës	Përkufizimi i potencialeve prioritare dhe zgjidhjet.		3 mbledhje
Koordinatorët	Përkufizimi i Planit Strategjik në kuadër të dokumentit “Axforda e Gjellbër”.		1 muaj
Koordinatorët	Miratimi i dokumentit, pilot-projektet, monitorimi.		

Këtë Tabelë duhet ta kenë të gjithë pjesëmarrësit në proces, pa dallim nëse janë pjesëmarrës aktiv në punën e grupeve të punës apo vetëm dëshirojnë të informohen për procesin dhe progresin e punës. E rëndësishme është që e gjithë puna nëpër grupe të punës të jetë transparente dhe publike. Të gjitha takimet duhet të jenë publike dhe të hapura, ndërsa mundësisht të njoftohet edhe komuniteti për vendin dhe kohën e mbledhjes, si dhe për temën.

Në këtë mënyrë do të mund të inkuadrohet një numër më i madh i qytetarëve, të cilët do të mund të japin kontributin e tyre në ato pjesë për të cilat konsiderojnë se kanë njohuri dhe potencial.

FAZA 1. Nisma dhe përgatitja

Kjo fazë më së shumti ka të bëjë me organizatën e cila do ta zbatojë procesin.

Organizata, e cila është implementuese dhe bartëse e aktiviteteve, duhet të jetë e përgatitur për punë me palët e prekura e të interesuara të cilat, marrë në përgjithësi, nuk janë anëtarë të sektorit të OJQ-së. Ata janë qytetarë të thjeshtë, ndërsa disa prej tyre për herë të parë ballafaqohen me SHQ dhe aktivitete projektuese. I gjithë procesi varet nga qytetarët dhe është për qytetarët. SHQ e cila e zbaton procesin është vetëm logjistike e të njëjtit dhe qytetarëve u ndihmon për ta realizuar atë që dëshirojnë, me qëllim që t'i ruajnë dhe promovojnë vlerat e përbashkëta të komunitetit.

Përpara se të arrihet çfarë do qoftë kontakti me komunitetin, të cilin e keni apostrofuar si “Axxhendë të Gjelbër”- komunë potenciale, Ju, si shoqatë qytetare, duhet të jeni e gatshme për ta implementuar procesin deri në fund.

Gatishmëria e SHQ-së është vendimtare për implementimin e të gjitha aktiviteteve dhe fazave të procesit.

Nëse jeni SHQ, e cila punon në komunitet tjetër, domosdoshmërisht duhet të bëni kërkime për të njëjtin dhe të mësoni çdo gjë për traditën dhe zakonet lokale, por edhe për mënyrën e funksionimit të tij.

Pa marrë parasysh nëse jeni SHQ nga komuniteti ose jo, duhet ta keni mbështetjen nga pushteti lokal dhe nga kryetari i komunës, si dhe të vendosni marrëdhënie partneriteti me komunën, ngaqë kjo do të jetë me dobi të madhe për të dyja palët e involvuara.

Për të vazhduar më tutje me punë është i domosdoshëm Memorandumi për bashkëpunim midis jush dhe pushtetit komunal.

NXITJA DHE PËRGATITJA E PROCESIT

Kjo është faza përgatitore e cila duhet të nxisë interesim për procesin në komunitetin në të cilën zbatohet.

Kjo është faza në të cilën duhet të përcaktohen të gjitha palët e interesuara që duhet të përfshihen në proces.

Aktivitetet orientohen drejt promovimit të procesit dhe në drejtim të grumbullimit të të gjitha informatave, të cilat do të shfrytëzohen më vonë, gjatë punës në komunitet.

Varësisht nga madhësia e komunitetit në të cilën punoni, duhet ta zgjidhni metodën më efektive për promovimin e procesit në komunitet. Një gjë e tillë mund të arrihet me:

- shfrytëzimin e mediave lokale;
- takimet me qytetarë;
- vizitat prej shtëpie në shtëpi dhe informimin e banorëve të komunitetit me procesin.

Procesi “Akhenda e Gjellbër” në Maqedoni ofroi disa metoda të ndryshme të promovimit të procesit dhe informimit të komunitetit. Meqë bëhet fjalë për tri komuna me madhësi të ndryshme, organizatat-bartëse të procesit zgjodhën metoda të ndryshme të promovimit dhe aktualizimit të “Akhendës së Gjellbër”.

Më e madhja sipas numrit të banorëve, Komuna e Manastirit, e promovoi procesin përmes shfrytëzimit të mediave lokale dhe përmes “**ambasadorëve të gjellbër**”, të cilët procesin e promovuan me anë të kontakteve të drejtpërdrejta me qytetarët, shpërndarjen e materialit propagandues për “Akhendën e Gjellbër” dhe paraqitjen vizuale origjinale dhe emblematike të ambasadorëve.

Komuna më e vogël, Komuna e Vevçanit, procesin e promovoi përmes kontakteve të drejtpërdrejta me popullatën dhe shpërndarjen e materialit informativ për “Akhendën e Gjellbër”. Në Vevçan u mbajt edhe takimi me qytetarët e interesuar, në të cilin u promovua procesi.

Në Vevçan, qytetarët vlerat i përcaktuan përmes anketës, e cila u realizua me 200 të anketuar, ndërkaq numri i anketave të kthyera ishte 150. Rezultatet e anketës së realizuar shërbyen për përcaktimin e vlerave dhe prioriteteve të komunitetit.

AXHENDA E GJELBËR



INKUADROHU EDHE TI!

TEL/FAX: 234 973

e - mail: biosfera@mt.net.mk

www.biosfera.org.mk

PROJEKTI ZBATOHET ME MBËSHTETJE FINANCIARE TË PROGRAMIT PËR MJEDISIN JETËSOR TË BALLKANIT PERËNDIMOR NGA MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME TË HOLANDE

ÇKA ËSHTË AXHENDA E GJELBËR

- Axhenda e Gjelbër (Plani i Gjelbër) paraqet koncept kompatibil të Axhendës Lokale 21. Nocioni Axhenda e Gjelbër e shfrytëzohet për ta sqaruar procesin i cili përfshin grupe dhe sektorë të ndryshëm të komunitetit lokal dhe si rezultat i pjesëmarrjes dhe punës së tyre aktive vijojnë aktivitetet dhe plane për ardhmërinë. Planet e hedhura në letër nuk janë rezultat i fundit i procesit por zbatimi i tyre.
- Ky është një proces dinamik dhe transparent i cili shpjen në informata të reja, plane dhe ide që mund të përfshihen në versionin e ri të dokumentit i cili mund të zbatohet pas një periudhe të caktuar kohore.
- Qëllimi kryesor i Axhendës së Gjelbër është që ta inkurajojë dhe përmirësojë komunikimin dhe bashkëpunimin ndërmjet qytetarëve me pushtetin lokal, biznes sektorin me shoqatat qytetare në drejtim të realizimit të objektivave të përbashkëta – përmirësimin e cilësisë së jetës në nivel lokal përmes zbatimit të parimeve për zhvillim të qëndrueshëm.

PRINCIPET E ZBATIMIT

- *Pjesëmarrja e publikut në procesin e planifikimit;
- *E promovon dhe nxit zhvillimin e partneritet ndërmjet aktorëve të ndryshëm: qytetarë, pushteti lokal, biznesi, shoqatat e qytetarëve dhe donatorë;
- *Zhvillon strategji dhe plan veprimi si dokumente strategjike;
- *Pjesëmarrja e aktorëve të ndryshëm në drejtim të zbatimit të aktiviteteve të realizuara me Plan veprimin;
- *Aktivitetet orientohen jo vetëm në drejtim të mbrojtjes së mjedisit jetësor por edhe në drejtim të aspekteve sociale dhe ekonomike dhe rezultoni me përmirësimin e cilësisë së jetës në nivel lokal;
- *Puna fokusohet në drejtim të mbrojtjes së **VLERAVE** të komunitetit lokal në aspekt të mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe natyrës, kulturës, traditës, nga aspekti social dhe ekonomik i jetës bashkëkohore dhe për çdo gjë tjetër për të cilën qytetarët do të vendosin se është e rëndësishme për ata.

PLANI I ZBATIMIT NË MANASTIR

TETOR 2007

- Aktivitetet përgatitore;
- Informimi i publikut më të gjerë;
- Përpilimi i listës dhe kontaktit me aktorët e interesuar për pjesëmarrje në procesin Axhenda e Gjelbër Manastir;

NËNTOR

- Përgatitja e mbledhjes së përbashkët me të gjithë aktorët dhe të interesuarit për procesin;

DHJETOR

- Mbledhje dhe formimi i grupeve të punës;
- Trajnimi për punën e grupeve të punës dhe përmirësimi i shkathtësive të tyre;
- Përpilimi i strategjisë me plan veprim dhe lobim për miratim nga pushteti lokal.

JANAR 2008

- Përpilimi i propozimit projekteve të para.

SHKURT

- Zbatimi i projekteve.

MARS

- Monitorimi dhe vlerësimi i procesit Axhenda e Gjelbër në Manastir.

Fletëpalosje për promovimin e “Axhendës së Gjelbër” në Manastir

HAPI 1: PËRCAKTIMI I PALËVE TË INTERESUARA DHE ANALIZA E DOKUMENTEVE

Objektivi: Përcaktimi i palëve të interesuara, pra i të gjitha grupeve ose individëve me interesa të ndryshëm mbi të cilët ndikon procesi. Analizat përfshijnë edhe analizë të mjedisit të tyre, të marrëdhënieve të tyre të ndërsjella dhe marrëdhënieve të fuqisë së interesave në atë proces. Me përfundimin e këtij hapi do të rezultojë:

Lista e palëve të interesuara – individë ose grupe, ndërmarrje ose shërbime shtetërore – listë kjo në të cilën do të gjenden të gjithë ata mbi të cilët mund të ndikonte procesi (pozitivisht ose negativisht).

Lista e ligjeve, strategjive, dokumenteve, projekteve të realizuara paraprake të cilët kanë ndonjë ndikim mbi procesin.

Listat e dokumenteve të Arkivit të pushteti lokal, të cilat do të mund të ndikonin mbi procesin e “Axhendës së Gjellbër”. Të gjitha dokumentet strategjike të pushtetit lokal, të gjitha rregullat dhe rregulloret që kanë të bëjnë me procedurat, aktvendimet për lëshimin e lejeve, planet kadastrale të komunës, lista të objekteve dhe vendeve të trashëgimisë kulturore.

Përveç këtyre hulumtimeve dhe grumbullimit të të dhënave, duhet të përgatitet edhe lista e të gjitha shoqatave të qytetarëve të komunitetit ku do të punoni. Kërkojeni nga ata atë që e kanë bërë në komunitet në mënyrë që të mund t'i shfrytëzoni edhe të dhënat e tyre.

Në Komunën e Vevçanit fillimi i procesit ishte mjaft specifik ngaqë organizata bartëse e tërë procesit nuk është nga Vevçani. NJV “Kërste Jon”, “Qendra e Gjellbër” është organizatë nga Struga, e cila ka punuar disa projekte në Vevçan si partnere dhe nuk ishte e njohur sa duhet me marrëdhëniet dhe proceset në Vevçan. Me qëllim të lehtësimit të punës dhe mbledhjes së më tepër të dhënave, ata së pari organizuan takim me shoqatat e qytetarëve të Vevçanit të cilat u inkuadruan si partner në tërë procesin.

Këtë analizë e zbatoi SHQ e cila e inicioi procesin. Këto dokumente fitohen përmes bashkëpunimit të drejtpërdrejt me administratën lokale, përmes konsultimit të

ligjeve të RM-së, si dhe me anë të analizave të të gjitha planeve dhe strategjive të RM-së në të cilat është përfshirë komuna juaj.

Nëse bëhet fjalë për komunitet e cili nuk ka strategji ose analiza, rekomandohet të bisedohet me anëtarë më të moshuar të atij komuniteti, të cilët do t'ju japin të dhëna për marrëdhëniet në të.

Hapi 1. Përcaktimi i palëve të interesuara		
Të përcaktohen palët relevante të interesuara. Të analizohen të gjitha palët e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të cilat mund të ndikojnë mbi procesin e “Axfordës së Gjellbër”.		
Kategoria	Palët e interesuara	Interesat
P.sh. në nivel lokal, konsumatorë, sektor privat	P.sh. Firmat, pronarë të tokave, tregtarë	P. sh. Interesa të drejtpërdrejta dhe të tërthorta

Lista e detajuar e palëve të interesuara:

Persona fizikë			
Emri dhe mbiemri	Funksioni në komunitet	Përvoja dhe kualifikimet/kontakti	A mund të ndikojë në “AGJ”
Institucione publike			
Emri dhe mbiemri	Funksioni i institucionit	Personi përgjegjës/kontakti	A ndikon në “AGJ”
Sektori i biznesit			
Emri dhe mbiemri	Dega ekonomike	Pronari/kontakti	A ndikon në “AGJ”

Lista e dokumenteve, strategjive dhe rregullave në nivel lokal dhe nacional

Dokumenti (përshkrimi i dokumentit)	Lokal / Nacional	Përshkrimi	Kush e implementon	I miratuar më/zgjatë deri

FAZA 2: PËRGATITJET PËR PUNË NË KOMUNITET (NË GRUPE TË PUNËS) DHE MBLEDHJE TË RREGULLTA

Objektivi: Të përforcohet ideja në komunitet dhe aty të organizohet puna.

Përshkrimi: Në këtë fazë të zhvillimit të procesit fillojnë kontaktet e drejtpërdrejta me anëtarët e komunitetit dhe organizohet puna në të. Në këtë fazë formohen grupet e punës me qytetarë dhe organizohen mbledhje të rregullta të grupeve të punës. Nga mbledhjet me grupet e punës, të përbëra nga anëtarë të komunitetit, duhet të rezultojë zhvillimi i mëtejshëm i procesit të “Axhendës së Gjelbër”, si dhe të fitohen të dhënat themelore të cilat do të shërbejnë si bazë për përpilimin e dokumentit strategjik.

Qytetarët duhet të animohen dhe atyre t’u sqarohet se çka në fakt është “Axhenda e Gjelbër”. Një gjë e tillë duhet të sqarohet në atë mënyrë që do të jetë e kuptueshme për të gjithë dhe në këtë mënyrë qytetarët të interesohen për procesin dhe të marrin pjesë aktive.

Që në mbledhjen e parë me palët e interesuara do të vërehet se sa keni qenë të shkathët në sqarimet e asaj që është thelbësore për “Axhendën e Gjelbër”. Mbi bazë të numrit të të pranishmëve do të shihni nëse metoda të cilën e keni përdorur është e suksesshme, ndërkaj do ta shihni edhe ardhmërinë e procesit në tërësi.



HAPI 2: MBLEDHJA E PARË E PALËVE TË INTERESUARA

Kjo nuk është mbledhje e grupeve të punës! Nuk është mbledhje e ekspertëve dhe njohësve të rrethanave të komunitetit dhe krijuesve të opinionit publik.

Mbledhja e palëve të interesuara është takim publik në të cilin janë ftuar të gjithë banorët dhe në të cilin qytetarët duhet t'i përcaktojnë vlerat më të rëndësishme të komunitetit, të cilat do të jenë bazë për ecurinë e mëtutjeshme të punës.

Para mbledhjes, do të jetë e pëlqyeshme të vlerësohen nevojat dhe interesat e një grupi më të gjerë i të interesuarve për çështje të caktuara, ndërsa informatat e nevojshme për këtë më së lehti mund të fitohen përmes një pyetësi ose ankete. Për sa u përket palëve më të rëndësishme të interesuara, kontakti i drejtpërdrejt me ta do t'i nxisë për t'u inkuadruar, mund të rritet mirëkuptimi i tyre, gjithashtu edhe interesimi i tyre për pjesëmarrje aktive.

Varësisht nga madhësia e komunitetit, në të cilën punoni, mund të keni edhe disa mbledhje përgatitore me grupe të ndryshme të palëve të interesuara. Këto mbledhje janë parapërgatitje e mirë para mbledhjes së parë publike me të gjitha palët e interesuara.

Rezultat i mbledhjes së parë me palët e interesuara duhet të jetë formimi i grupeve të punës dhe fushave prioritare në të cilat do të punojnë grupet.

Varësisht nga numri i vlerave të përcaktuara do të varet edhe numri i grupeve të punës. Nëse në mbledhjen e parë me palët e interesuara i përcaktoni grupet e punës sipas fushave me prioritet, atëherë insistoni që të pranishmit të deklarohen se në cilin grup të punës dëshirojnë ta japin kontributin e tyre dhe regjistrojeni mënyrën për t'i kontaktuar ata me qëllim që t'i informoni për kohën dhe vendin e mbledhjes së parë të grupit të punës.

Numri i anëtarëve të grupit të punës nuk është i kufizuar, procesi i punës do ta përcaktojë numrin, përkatësisht mos prisni se që të gjithë ata që janë paraqitur për pjesëmarrje në grup të punës të mbeten aty deri në fund.

Pasi të përcaktohen vlerat dhe numri i grupeve të punës, duhet t'i përgatitni materialet për mbledhjen e parë me grupet e punës.

Dokumentet e nevojshme për mbledhjen e parë:

1. Plani i punës për periudhën e ardhshme.
2. Format i procesverbalit.
3. Format i raportit.
4. Lista e pjesëmarrësve të pranishëm.
5. Plan veprimi i grupit të punës.

Ky është hapi fillestar i punës në grupet e punës.

Çdo grup i punës duhet të mbajë mbledhje përgatitore. Mbledhjen duhet ta thirr dhe ta mbajë koordinatori i projektit, i cili do t'i përgatitë anëtarët e grupeve të punës për hapat vijues. Për mbledhjet e para mund të kërkonit edhe ndihmë nga trajneri, nëse konsideroni se keni nevojë për një gjë të tillë.

Në mbledhjen e parë, e cila duhet të jetë e ndarë me çdo grup të punës përcaktohet si vijon:

1. **Rregullat e grupit të punës**- meqë bëhet fjalë për grup joformal me angazhim vullnetar të anëtarëve, duhet të merren vesh për terminet e mbledhjeve të grupit, i cili do t'u konvenojë të gjithë anëtarëve.
2. **Të vendoset rregull për mbajtjen e shënimeve dhe ruajtjen e shënimeve dhe procesverbaleve** të mbledhjeve të cilat janë të rëndësishme për krijimin e dokumentit strategjik "Akhenda e Gjellbër".
3. **Të zgjidhet koordinatori i grupit të punës.** Funkzioni i koordinatorit mund të jetë edhe me rrotacion. Koordinator i projektit është ai që duhet tua sqarojë procesin e "Akhendës së Gjellbër" koordinatorëve lokalë, por edhe më mirë është që të zbatohet trajnim për procesin në të cilin do të marrin pjesë koordinatori lokal dhe koordinatorët e grupeve të punës, në mënyrë që të mund të zbatohet procesi sa më qartë dhe më me sukses.

Vevçan:

3 grupe të punës të cilat i zgjodhën koordinatorët e tyre të përhershëm (përfaqësues të OJQ-ve), ndërkaq secili grup zgjodhi edhe protokollistin. Protokollisti e mban evidencën e mbledhjeve dhe i grumbullon të gjitha materialet dhe shënimet nga mbledhjet. (Shembull – Procesverbalin dhe raportin).

Në mbledhjen e parë secili grup duhet të përpilojë plan veprim dhe tabelë kohore të mbajtjes së mbledhjeve, varësisht nga hapat që duhet të realizohen. Koordinator i projektit duhet të përgatis materiale me sqarime për secilin hap veç e veç, si dhe tabela për evidentimin e të dhënave për çdo hap.

Shembull: Rendi i ditës

Rendi i ditës:

1. Prezantimi i planit për punën e vitit të ardhshëm.
2. Prezantimi i hapave të cilët duhet t'i realizojnë grupet e punës.
3. Puna në grupe.
4. Zgjedhja e koordinatorit të grupit.
5. Mënyra e koordinimit të grupit të punës dhe ndërmjet grupeve.
6. Përgatitja e planit të punës (secili grup veç e veç).



Atmosfera nga mbledhja e parë me palët e interesuara në Dellçevë

Shembulli 1: Rendi i ditës

Propozim-rendi i ditës për mbledhjen e parë të grupeve të punës

Varianti 1

Në variantin e parë, të gjitha grupet e punës janë në një vend, punohet së bashku, me atë që në pjesën e dytë ata ndahen nëpër grupe.

1. Mirëseardhja dhe prezantimi i “Kërste Jon”/ “Kocka”.
2. Prezantimi i pjesëmarrësve në grupet e punës dhe interesat e tyre.
3. Hyrje në punën e grupeve të punës:
 - si organizohen grupet e punës;
 - si mbahet mbledhja dhe elementet e nevojshëm të takimit të parë;
 - zgjedhja e udhëheqësve të grupeve të punës.
4. Ndarja nëpër grupe të punës (3).
5. Puna nëpër grupe-radhitja e prioriteteve në kuadër të secilit grup.
6. Diskutim përfundimtar.

Varianti 2

Në variantin e dytë, grupet e punës takohen veç e veç.

1. Mirëseardhja dhe prezantimi i “Kërste Jon”/ “Kocka”.
2. Prezantimi i pjesëmarrësve në grupin e punës dhe interesave të tyre.
3. Radhitja e prioriteteve - „brainstorming“ dhe grupimi i prioriteteve.
4. Hyrje në punën e grupeve të punës:
 - si organizohen grupet e punës;
 - si mbahet mbledhja dhe, elementët e nevojshëm të një mbledhjeje;
 - zgjedhja e udhëheqësve të grupeve të punës.
5. Diskutim përfundimtar.

Shembulli 2:

Takimi i parë me palët e interesuara për “Axfendën e Gjelbër” në komunën Dellçevë

- Hapja e takimit dhe prezantimi i “Kocka”, të “Qendrës Rajonale të Përfaqësimit” dhe të Stafit për zbatimin e “Axfendës së Gjelbër”.
- Prezantimi i QRP-së dhe të Stafit për implementim – Toni Stoimenovski.
- Prezantimi i “Kocka” dhe Milieukontakt” – (gjithsej 10 minuta).
- Prezantimi i Projektit “Axfenda e Gjelbër” të Komunës Dellçevë.
- Prezantimi i përvojave të programeve të zbatuara në Kroaci dhe Moldavi – “Kocka” (KOCKA) – 15 deri 20 minuta.
- Diskutim dhe pyetje pas prezantimeve – maksimum 20 minuta.

Shembull:

Procesverbal nga mbledhja e mbajtur

Mbledhja nr: _____

Vendi: _____

Koha: _____

Data: _____

Grupi i punës:

Koordinatori:

Protokollisti:

Prezent:

Tema : _____

PROCESVERBAL

Shembull: Raport nga mbledhja e mbajtur

Mbledhja nr: _____

Vendi: _____

Koha: _____

Data: _____

Grupi i punës:

Koordinatori:

Raporti për : _____

RAPORTI

Shembulli 2:

PROCESVERBAL

Nga Mbledhja e parë e mbajtur me palët e mundshme të interesuara të përfshira në procesin e “Axfordës së Gjellbër” në Komunën e Manastirit.

Mbledhja u mbajt më datë 04.12.2007, në Hotelin “Epinal”, në Manastir me fillim në ora 13:00, ndërsa përfundoi në orën 14:15 minuta.

Në mbledhje morën pjesë 28 persona, përfaqësues të qytetarëve, të institucioneve arsimore, ndërmarrjeve publike, pushtetit lokal dhe të partive politike.

Mbledhja u zhvillua sipas Rendit të ditës të paraparë.

Në fillim, Neshat Azemovski, në cilësinë e koordinatorit të procesit “Axforda e Gjellbër”, iu drejtua të pranishmëve dhe e sqaroi mënyrën se si erdhi deri te mbajtja e kësaj mbledhje.

Pas prezantimit të pjesëmarrësve pasoi sqarimi i procesit “Axforda e Gjellbër” nga ana e Juliana Daskallov.

Pyetjet e të pranishmëve kishin të bëjnë me mundësinë e përfshirjes edhe të personave të tjerë, me përvojat e komunave dhe shteteve tjera, si dhe me hapat e procesit.

Mbledhja u mbajt në një atmosferë pozitive dhe në fund u miratua konkluzioni që mbledhja e radhës të mbahet më datë 27 dhjetor.

Protokolliste:

Aleksandra Stojanovska

PROCESVERBAL

nga Mbledhja e dytë e mbajtur me palët e mundshme të interesuara të përfshira në procesin e “Axhendës së Gjelbër” në Komunën e Manastirit

Mbledhja u mbajt më datë 27.12.2007, në Hotelin “Epinal”, në Manastir me fillim në ora 13:00, ndërsa përfundoi në orën 13:55 minuta.

Në mbledhje morën pjesë 30 persona, përfaqësues të qytetarëve, të institucioneve arsimore, ndërmarrjeve publike, pushtetit lokal dhe të partive politike.

Mbledhja u zhvillua sipas Rendit të ditës të paraparë.

Pas fjalës hyrëse të koordinatorit të Projektit u prezantuan grupet e punës të cilat rezultuan përmes hulumtimit të zbatuar nga ambasadorët e “Axhendës së Gjelbër”, kontaktit të drejtpërdrejt me palët e interesuara dhe personave të ftuar të marrin pjesë në këtë proces.

Të pranishmit u ndanë sipas interesit për pjesëmarrje nëpër grupe të punës dhe deri në fund të mbledhjes kishin mundësi të diskutojnë për gjendjen e përgjithshme dhe përpunimin e ideve të mundshme.

Grupet e punës janë si vijojnë:

UJI DHE UJËRAT E ZEZA

Personi përgjegjës: Ruzha Petrova

PROMOVIMI I EKO-TURIZMIT NË KOMUNËN E MANASTIRIT

Personi përgjegjës: Romeo Micevski

GJELBËRIMI I SIPËRFAQEVE PUBLIKE

Personi përgjegjës: Aleksandra Stojanovska

FËMIJËT VLERË E MANASTIRIT

Personi përgjegjës: Lidija Angelkova

FORMIMI I QENDRËS EDUKATIVE PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM

Personi përgjegjës: Hristo Dimitrovski

Kanë rënë dakord që të kërkojnë nga Komuna e Manastirit një lokal i cili do të vihet në funksion të procesit të “Axhendës së Gjelbër” me qëllim që një numër sa më i madh i qytetarëve të inkuadrohen dhe ta japin kontributin e tyre për zbatimin e suksesshëm të të njëjtës.

Koordinatori i “Axhendës së Gjelbër” duhet t’i ndërmerr aktivitetet e domosdoshme.

Protokollist,

...

Shembull: Plan veprimi i grupit të punës

Grupi i punës: _____

Koordinator: _____

Mbledhja nr.	Data	Vendi	Kohëzgjatja	Tema (hapi i planit të punës)	Vërejtje

Shembulli 1:

Aktiviteti	Përgjegjës për implementimin	Koha
1 Rezultati: Grupet e punës e implementojnë procesin e krijimit të “Axfordës së Gjellbër”		
Trajnim për hapat e “Axfordës së Gjellbër”	“K Jon” dhe trajnerët	Fundjava e parë e muajit prill
Trajnim për planifikim strategjik	“K Jon” dhe trajnerët	Fundjava e parë e muajit prill
Vizita e grupeve të punës në Manastir dhe Dellçevë	Grupe të punës dhe koordinatori	Maj dhe Qershor
2 Rezultati: Dokument i përpiluar dhe miratuar për „Axfordën e Gjellbër“ të Komunës së Vevçanit		
Mbledhje të grupeve të punës për realizimin e hapave të fazës 3	Grupet e punës, koordinatori, asistenti	Prill-Qershor

Mbledhjet e grupeve të punës për realizimin e hapave të fazës	Grupet e punës, koordinatori, asistenti	Qershor-Shtator
Draft versioni i gatshëm i dokumentit të "AGJ"	Grupet e punës	Tetor 2008
Grumbullimi i komenteve për draft-versionin	Koordinatori, koordinatorët e grupeve të punës	Tetor 2008
Përpunimi final i dokumentit i ndryshuar dhe plotësuar mbi bazë të komenteve të pranuar	Koordinatori, grupet e punës	Nëntor 2008
Seanca e Këshillit të Komunës për miratimin e dokumentit si dokument zyrtar të Komunës Vevçan	Këshilli i Komunës	Dhjetor 2008
3 Rezultati : Implementimi i 3 pilot-projekteve në komunitet		
Përcaktimi i prioriteteve (çdo grup i punës 1)	Grupe të punës Koordinatorë të gr. të punës	Prill - Qershor
Përgatitja e propozim-projekteve për prioritetet	Grupet e punës, koordinatorë të gr. të punës, Koordinator i "AGJ"	Maj - Qershor
Implementimi i projekteve në komunitet	Grupe të punës, koordinatorë të gr. të punës, koordinator, qytetarë lokal	Korrik - Shtator
4 Rezultati: Promovimi i "Axhendës së Gjellbër" në publik		
Publikimi i rregullt i informatave në ueb-faqe	Personi për marrëdhënie me publikun	Prill 2008 - Prill 2009
Përgatitja dhe botimi i materialit promovues	Personi për marrëdhënie me publikun	Shkurt 2009
5 Rezultati : Takim nacional për promovimin e "Axhendës së Gjellbër"		

HAPI 3: Identifikimi i funksioneve të mjedisit jetësor

Objektivi: Objektivi i zbatimit të këtij hapi është të kompletohet lista e funksioneve të mjedisit jetësor për vlerën në të cilën punon grupi i punës.

Përshkrimi: Sipas pikëpamjeve të anëtarëve të grupit të punës duhet të ceken të gjitha funksionet e mundshme që i kryen prioriteti i zgjedhur, përkatësisht vlerat. Duhet të mendohet mirë dhe të diskutohet për të gjitha funksionet dhe të gjithë të regjistrohen në formatin e dhënë për këtë mbledhje.

Është mirë që koordinatori, në fillim të mbledhjes, të bëjë sqarimin se ç'është funksion, ndërsa pastaj të kalohet në shqyrtimin dhe sqarimin e të gjitha funksioneve të cilat do t'u kujtohen anëtarëve të grupit.

Ky hap duhet të përpunohet në hollësi ndërkaq, nga përvoja paraprake, është mirë të mbahen më së paku 2 mbledhje të grupit të punës për përcaktimin e funksioneve të mjedisit jetësor.

Lista e funksioneve është bazë për zbatimin e hapave të ardhshëm, por edhe për përkufizimin e vlerës në të cilën punon grupi i punës. Funksionet ndahen në disa kategori (primare, sekondare, rregulluese dhe funksione për begatimin e kulturës) .

Shembull:

Hapi 3: Përcaktimi i funksioneve të mjedisit jetësor	
Objektivat:	
Funksioni (vlerat)	Përshkrimi i funksionit

Shembull: Tabela e funksioneve

Funksione primare prodhuese	
Prodhime të natyrës	
Ujë i pijshëm për njerëzit	
Ujë për ujitje	
Resurse gjenetike	
Prodhime me prejardhje bimore dhe shtazore	
Ushqim për njerëzit	
Funksione sekondare	
Prodhime për kafshët	
Të mbjella bujqësore	
Materiale ndërtimore	
Pyje	
Funksione rregulluese	
Rregullimi i rrjedhës së ujit	
Kapacitetet e tokës për mbajtjen e ujërave dhe tokës	
Rigjenerimi dhe mirëmbajtja e pjellshmërisë së tokës	
Pyje që përpunojnë/absorbojnë një pjesë të karbonit nga atmosfera në kontekst të ngrohjes globale	

Shembull i plotësuar (i pasqyruar në tabelën më poshtë)

Hapi 3: Përcaktimi i funksioneve të mjedisit jetësor (vlerave)	
Objektivi: Të përkufizohen funksionet e mjedisit jetësor (vlerave) në komunitet mbi bazë të mendimit dhe konkluzioneve të anëtarëve të grupeve të punës.	
Funksione primare prodhuese	
Prodhime të natyrës	livanda, gështenja, boronica, mendra, borziloku, trëndafili i egër, molla, dardha, manaferra
Ujë të pijshëm për njerëzit	Burime – ujësjellës adekuat dhe rrjet kanalizimi
Ujë për ujtitje	Kanale dhe ujë burimorë
Resurse gjenetike	
Prodhime me prejardhje bimore dhe shtazore	qumësht dhe prodhime qumështore (djathë, gjizë, ajkë, kaçkavall), verë, raki, mjaltë, prodhime kopshtore
Ushqim për njerëz	qumësht dhe prodhime qumështore (djathë, gjizë, ajkë, kaçkavall), verë, raki, mjaltë, prodhime kopshtore
Funksione sekondare	
Prodhime për kafshët	misër, grurë, sanë
Të mbjella bujqësore	misër, grurë, groshë, rrush, domate, speca, patate, kumbulla
Materiale ndërtimore	materiale prej druri
Pyje	gështenjë, dushk, ah,verri, panjë, pishë e zezë, pishë e bardhë, dëllinjë, bredh
Funksione rregulluese	
Rregullimi i shkarkimit të ujit	sistem modern të ujësjellësit dhe kanalizimit në Vevçan dhe rrethinë
Kapaciteti i tokës për mbajtjen e ujërave dhe tokës	
Rigjenerimi dhe mirëmbajtja e pjellshmërisë së tokës	
Pyje që përpunojnë/absorbojnë një pjesë të karbonit nga atmosfera në kontekst të ngrohjes globale.	

Shembull:

Funksionet e mjedisit jetësor:

Vevçan

Funksione primare prodhuese:

- prodhime të natyrës;
- ujë i pijshëm;
- ujë për ujitje;
- resurse gjenetike;
- prodhime me prejardhje bimore dhe shtazore;
- ushqim për njerëz.

Funksione sekondare prodhuese:

- prodhime për kafshët;
- të mbjellja bujqësore;
- materiale ndërtimore;
- pyje.

Rregullime (funksione mbrojtëse):

- rregullimi i rrjedhës së ujit;
- kapacitetet e tokës për mbajtjen e ujit dhe tokës;
- shmangia dhe asgjësimi i mbeturinave;
- rigjenerimi dhe mirëmbajtja e pjellshmërisë së tokës;
- pyje që përpunojnë/ absorbojnë një pjesë të karbonit nga atmosfera në kontekst të ngrohjes globale.

Funksione primare prodhuese	
Prodhime të natyrës:	- livanda, - gështenja, - boronica, - mendra, - borziloku, - trëndafili i egër - molla, - dardha, - manaferra.
Ujë i pijshëm për njerëzit:	Burime – ujësjellës adekuat dhe rrjet kanalizimi
Ujë për ujitje	kanale dhe ujë burimorë
Resurse gjenetike	?????
Prodhime me prejardhje bimore dhe shtazore	- djathë, - qumësht, - gjizë, - ajkë,

	<ul style="list-style-type: none"> - kaçkavall, - verë, - raki, - mjaltë, - prodhime kopshtore.
Ushqim për njerëzit:	<ul style="list-style-type: none"> - djathë, - qumësht, - gjizë, - ajkë, - kaçkavall, - verë, - raki, - mjaltë, - prodhime kopshtore.

Funksione sekondare	
Prodhime për kafshët:	<ul style="list-style-type: none"> - misër, - grurë, - sanë,
Të mbjella bujqësore:	<ul style="list-style-type: none"> - misër, - grurë, - groshë, - bizele, - rrush, - domate, - specë, - patate, - kumbulla.
Material ndërtimor:	- material prej druri.
Pyje:	<ul style="list-style-type: none"> - gështenjë, - dushk, - ah, - verri, - panjë, - pishë e zezë, - pishë e bardhë, - dëllinjë, - bredh.

Funksione rregulluese	
Rregullimi i rrjedhës së ujit.	
Kapacitetet e tokës për mbajtjen e ujërave dhe tokës.	
Rigjenerimi dhe mirëmbajtja e pjellshmërisë së tokës.	
Pyje të cilat përpunojnë/absorbojnë një pjesë të karbonit nga atmosfera në kontest të ngrohjes globale.	

- Rregullimi i rrjedhës së ujit.
- Kapacitetet e tokës për mbajtjen e ujërave dhe tokës.
- Shmangia dhe asgjësimi i mbeturinave.
- Rigjenerimi dhe mirëmbajtja e pjellshmërisë së tokës.
- Pyje të cilat përpunojnë/absorbojnë një pjesë të karbonit nga atmosfera në kontest të ngrohjes globale.

Shembull (nga Manastiri, i prezantuar në formë integrale):



RAPORT NGA MBLEDHJA ME GRUPIN E PUNËS PËR EKO-QENDRËN (1)

Hapi 3: Funksionet e mjedisit jetësor

Më datë 21.08.2008, në ora 19:00, u mbajt mbledhja me Grupin e punës për Eko-qendrën “VOLVOKS”, në të cilën morën pjesë anëtarët e këtij grupi të punës.

Në mbledhje u bë fjalë për funksionet e mjedisit jetësor. Si konkluzion nga diskutimi i zhvilluar rezultoi se Manastiri dhe rajoni më i gjerë kanë nevojë për formimin e një qendre të këtij lloji, e cila do të funksiononte edhe si një lloj atraksioni turistik në Manastir dhe si vend në të cilin të rinjtë do të vinin në kontakt më të afërt me natyrën.

Propozimet për veprim: aktivizimi i një numri sa më të madh të personave profesionistë, si nga radhët e anëtarëve të “Biosferës” ashtu edhe nga jashtë, për përgatitjen sa më profesionale dhe më të mirë të mundshme të Eko-qendrës; stimulimi i sektorit të biznesit dhe ndërmarrjeve publike të qytetit për dhënin e kontributit të tyre personal për ndërtimin e Eko-qendrës.

Si funksione të mjedisit jetësor janë veçuar:

Funksionet primare:

- siguron hapësirë për jetë;
- mundësi për prodhimin e ushqimit;
- bukuri natyrore të pasur me diversitet biologjik.

Për Manastirin është potencuar që të shqyrtohen temat më të rëndësishme, më interesante dhe më specifike, si vijojnë:

- **Funksionet e diversitetit biologjik** (zona e Manastirit është përplot me vegetacion të shumëllojshëm, natyrë piktoreske, Parkun Nacional “Pelister” dhe pika të bukura natyrore), dhe
- **Funksionet e begatimit (kultura)** – Manastiri është përplot monumente kulturore-historike, të cilat ndërlidhen me natyrën dhe përbëjnë një tërësi të përbashkët.

Shembull (nga Manastiri, prezantohet forma integrale):



RAPORT NGA MBLEDHJA ME GRUPIN E PUNËS PËR EKO-TURIZËM (1)

Hapi 3: Funkcionet e mjedisit jetësor

Më datë 19.08.2008, në ora 18:00, u mbajt mbledhja me Grupin e punës për zhvillimin e eko-turizmit, në të cilën morën pjesë anëtarët e këtij grupi punues.

Në mbledhje u bisedua për **funkcionet e mjedisit jetësor**. Si konkluzione të këtij diskutimi rezultoi se Manastiri është i pasur me natyrë të mrekullueshme dhe me numër të madh të kishave e manastireve, dhe për këtë arsye ka bazë të mirë për zhvillimin e eko-turizmit.

Propozimet për veprim: bashkëpunim me shkollat fillore dhe të mesme për organizimin e ekskursioneve; bashkëpunim me shoqatën e gjuetarëve për shfrytëzimin e automjeteve të tyre për transportin e turistëve; eksplorimin e malit Baba nga ana greke Velushina dhe fshatrat përreth; përpilimin e internet-portalit në të cilin do të kishte informacione për të gjitha vendet për piknik dhe atraksionet turistike në Republikën e Maqedonisë.

Si funksion më i rëndësishëm i mjedisit jetësor është mundësia e zhvillimit të eko-turizmit si tendencë për gjenerimin e punësimeve të reja me përmbajtje të ndryshme që i ofron.

I njëjti bën pjesë në grupin FUNKSIONET E BEGATIMIT – vlerat që ndërtojnë lidhje ndërmjet njerëzve të cilat ato i përjetojnë ose i vlerësojnë.

Në mbledhje morën pjesë:

- Aleksandra Stojanovska,
- Nikollçe Nikolovski,
- Romeo Micevski,
- Katerina Mavrovska,
- Meri Bandevska,
- Neshat Azemovski.

Shembull (nga Manastiri, prezantohet forma integrale):



RAPORTI I MBLEDHJES ME GRUPIN E PUNËS PËR UJË (1)

Hapi 3: Funkzionet e mjedisit jetësor

Më datë 20.08.2008, në ora 19:00, u mbajt mbledhja me Grupin e punës për mbrojtjen e ujërave. Në mbledhje morën pjesë anëtarët e këtij grupi të punës.

Temë të bisedimit ishin funksionet e mjedisit jetësor. Gjithashtu, si karakteristika më të rëndësishme u diskutuan ujërat nëntokësor të Parkut Nacional “Pelister” dhe ujërat e akumulimit artificial “Strezhevo”, prej ku qyteti i Manastirit furnizohet me ujë të pijshëm në muajt e verës kur ndihet mungesa e resurseve të ujit.

Funksioni primar është funksioni prodhues primar – ujë të pijshëm për popullsinë.

Në mbledhje morën pjesë:

...

(Është dhënë lista e pjesëmarrësve)

Shembull (nga Dellçeva, prezantohet forma integrale):

Grupi i punës për kulturë dhe trashëgimi kulturore

“Akhenda e Gjellbër” - Dellçevë

1. Biblioteka, institucione kulturore dhe evenimente.

Dy institucione kulturore:

- Institucioni Nacional Qendra Kulturore “N. J. Vapcarov” – Dellçevë;
- Biblioteka Publike Lokale “Ilinden” - Dellçevë.

Evenimente tradicionale kulturore të cilat shënohen në këtë Komunë:

1. Ekspedita e shkurtit.
2. Takim tradicional i letrarëve me Konkurs shpërblyes 8- Mars.
3. Dita botërore e të rinjve dhe librit dhe e drejta e autorit (shënohet me program kulturor-artistik më datë 22 dhe 23 prill).
4. Dita e kryengritjes së Razlovci -20 maj.
5. Dita e kulturës në Republikën e Maqedonisë më datë 10 qershor.
6. Ditët e Goces-qershor.
7. 2- Gushti – Ilinden.
8. Takime Folklorike të Golakut (TFG) 8- gusht.
9. 7- Shtatori 2006.
Dita e çlirimit të qytetit tonë Dellçevë
10. 8 Shtatori 2006
Dita e miratimit të Kushtetutës-Dita e shtet-formimit të atdheut tonë Maqedonisë!
11. 11 Tetori – Dita e Kryengritjes Maqedonase dhe Dita e Luftëtarit
12. Muaji i librit, nga data 10 tetor deri më 10 nëntor.

2. Regjistrimi i monumenteve të kulturës, i numrit të kishave, manastireve, objekteve fetare

Kisha:

- “Ngritja në qiell e Shën Mërisë” - Dellçevë;
- “Shën Gjergji” fsh. Grad;
- “Shën Premtja Parasqevi” fsh. Selnik;
- “Shën Mëria” fsh. Trbotivishte;
- “Shën Athanasi”, fsh. Istevniku i Ri;
- “Shën Kolli”, Istevniku i Vjetër;
- “Shën Arhangjel Mihali”, fsh. Dramçe;
- “Shën Pantelejmon” në Golak;
- “Shën Car Konstantini dhe mbretëresha Elena”, fsh Razlovci;
- “Shën Kolli”, fsh. Virçe;
- “Shën Jovan Pagëzori” fsh. Xvegor.

Manastire:

- “Shën Mëria” – E Premtja Lindore Ballakli – e riparuar dhe rindërtuar – kompleks i manastireve;
- “Mbulesa e Shën Mërisë” e riparuar por e papërfunduar – kompleks i manastireve;
- “Shën Gjergji” tek Lisi i Gjurgjës në fsh. Virçe;
- “Shën Ilia fsh. Xvegor;
- “Shën Premtja” fsh. Cërkvinec.

Xhami:

- Xhamia në Dellçevë;
- Xhamia në fsh. Grad;
- Xhamia në fsh. Trabotivishte;
- Xhamia në fsh. Svegor;
- Xhamia në fsh. Gabrov.

3. Monumente të mbrojtura të kulturës

Nuk kemi të dhëna relevante.

Kemi të dhëna vetëm për kishën "Shën Premtja" në fsh. Selnik.

4. Gjetje arkeologjike dhe përmbledhje arkeologjike:**Lokalitete dhe të dhëna arkeologjike:**

- Varreza në fshatin Oçipal-është zbuluar karrocë e të vdekurve e cila është vendosur në Muzeun e Shtipit në Shtip;
- Varreza në fshatin Vetren-e eksploruar;
- Varreza në fshatin Virçe-e eksploruar;
- Varreza në fshatin Bigla-e eksploruar.

Ekzemplarët e ruajtur/zbuluar janë vendosur në ambientet arkeologjike-etnologjike brenda Qendrës së Kulturës "N.J. Vapcarov" - Dellçevë.

Varreza të pa-eksploruara ka në zonat rurale: Dramçe, Kosovo Dabje, Istevnik, Petrashevc, Iliovë etj.

Gjetjet-lokaliteti eneolit Gradishte në fshatin Grad, pjesërisht i eksploruar, ndërkaq ekzemplarët e konservuar janë vendosur në ambientet arkeologjike-etnologjike brenda Qendrës së Kulturës.

Numri i lokaliteteve të këtuja në zonën e Dellçevës është rreth 15 edhe atë në kufijtë e fshatit Xvegor, Grad, Çiflik ("Kulla"), Moshticë, Trabotivishtë, Razlovc, Virçe, Kamenicë, Iliovë, Oçipallë, Olshan Grad. Lokalitetet më të rëndësishme dhe më të mëdha gjenden në Kamenicë (Kulla) dhe Grad (Gradishtë).

- varrezë romake në Pijanec, janë eksploruar lokalitetet në fshatin Çipal dhe fshatin Dramçë;
- lagje rurale nga shekulli i mesëm brenda kufijve të fshatit Razlovc në vendin e quajtur "Gramadi", gërmime arkeologjike nga viti 2004;
- gjurmë nga vendbanimi parahistorik në zonën e Dellçevës;
- fragmentet e zbuluara nga qeramika në lokalitetin Çuka, i cili gjendet në kodrën e lartë në perëndim të Dellçevës i pa-eksploruar etj.

6. Monumente të regjistruara të kulturës dhe trashëgimisë kulturore

- Shtëpi përkujtimore e kryengritjes së Razlovcit në fshatin Razlovc;
- Shtëpi përkujtimore e KAÇKM-së në Dellçevë;
- Përmendorja "Goce Dellçev" në qendër të qytetit të Dellçevës;
- Përmendorja e dëshmorëve në qendër të qytetit të Dellçevës;
- Përmendorja e qytetarëve të pushkatuar nga Istevniku i Ri nga ana e gjermanëve gjatë LNÇ-së-në oborrin e shkollës të Istevnikut të Ri;
- Përmendorja e dëshmorëve nga LNÇ-ja në Obozna;
- Përmendorja e dëshmorëve nga LNÇ në hyrje të fshatit Razlovc;
- Pllakë përkujtimore për nder të Ditës së çlirimit dhe mitingu i mbajtur-e vendosur në murin e ndërtesës së parë në qendër të qytetit;
- Pllakë përkujtimore përkushtuar Ekspeditës së shkurtit-e vendosur në hyrje të pushimores për fëmijë në Gollak;
- Pllakë përkujtimore për Republikën e Pijanecit në qendër të Dellçevës;
- Tri pllaka përkujtimore të vendosura në vende të rëndësishme historike me rastin e 100 vjetorit nga Kryengritja e Ilindenit;

- Disa buste: Goce Dellçevi, Metodi Mitevski-Brico; Shën Klimenti i Ohrit; Nikolla J. Vapcarov etj.

6. Legjenda

Për krijimin e Pijanecit ekzistojnë disa legjenda

- Legjenda e emrit Pijanec ndërlidhet me bimën “pjavec”, e cila është rritur në grurë dhe thekër;
- Legjenda për konsumimin e pijes nga “pjaveci”;
- Legjenda e rakisë nga kumbulla etj.;
- Legjenda për emrin “Ilin-kamen” sipas emrit Ilina;
- Legjenda për Gollakun;
- Legjenda për kishën “Shën Pantelejmon”;
- Legjenda për çezmën Bun në Gollak;
- Legjenda për luginën e Liljanit në Trbotivishte dhe
- Legjenda të tjera për monumente të ngjashme të natyrës si dhe për çdo mëhallë të fshatrave të tipit të zhvilluar dhe legjenda për ujëra të shenjtë.

7. Monumente të natyrës

- Vendi i quajtur “Kukolje” fsh. Istevniku i Ri-i rregulluar përmes projektit;
- Vendi i quajtur “Kukolje”, fsh. Trbotivishte;
- “Gjurgjov-Dab” fsh, Virçe;
- “Gjurgjovo-Dabje” me gurë kishe fsh. Dramçë;
- “Bllagun-Dab” në fsh. Razlovc;
- Shpella në fsh. Kiselicë - e pa-eksploruar;
- “Ilin-kamen” në fsh. Svegor etj.

8. Kapacitete turistike

(hotele, vila, qendra rekreative, vende pikniku)

Hotele:

- “Makedonia”, në Qendrën e qytetit të Dellçevës;
- “Granit” në malin Golak,;

Motele:

- “Rudine-Krilce” ose “Biçetata” me të vjetrën;
- “Komit kallaj” tek stadiumi.

Qendra rekreative:

- “Gollak”.

Vende pikniku:

- Mali Gollak;
- Kompleksi i Manastirit “Manastirski endek”;
- Vendi i quajtur “Kukolje” fsh. Istevnik i Ri;
- “Gjurgjov-Dab” në fsh. Virçe;
- Shpella në fsh. Kiselicë dhe Livadhet e Kiselicës;
- Ilin-kamen në fsh. Svegor etj.;
- Ujërat e shenjtë dhe kisha “Shën Sofja” në fsh. Trbotivishte;
- Liqeni Sandanski;
- Liqeni Petrashevec.

PËRGJEGJËS: Toni Stojmenovski

Shembull (nga Dellçeva, është prezantuar në formë integrale):

“AXHENDA E GJELBËR”, Mbledhje e grupit “Mjedisi i pastër”,

02.04.2008 në ora 13:00

Përmes sublimimit të ideve nga të gjithë të pranishmit u numëruan funksionet/idetë/propozimet, si dhe çështjet që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e pastërtisë së mjedisit:

1. Pastrimi i shtratit të lumit Gabrovçicë, lumit Xverkorskë dhe lumit Bregallnicë.
2. Ndryshim i PDU në segmentin e Bul. “Makedonia” dhe rr. “Vera Jociq” për ndërtimin e garazheve nëntokësore, të cilat do të gjelbërohen në sipërfaqe.
3. Zëvendësimi i shtyllave ndriçuese ekzistuese me kandellabra solare.
4. Furnizimi i makinave për riciklimin e plastmasit.
5. Ngritja e ndërgjegjes ekologjike të popullatës (edukim+masa ndëshkuese).
6. Ndërtim i stacionit pastrues – Baza, SHA “Granit” dhe KIB “Sandanski”.
7. Koncesionimi i bregut – shëtitorës së lumit Bregallnica (Ligji për truall ndërtimor-kufizim i ideve të këtilla).
8. Rregullimi i WC-ve publike.
9. WC-e të montuara tek tregu.
10. Vendosja e koshave të plehrave.
11. Vendosja e ishujve të gjelbër.
12. Pastrimi i plehërishtave informale, sidomos të atyre rreth pompova për ujë të pijshëm.
13. Prishja e ndërtimeve pa leje.
14. Njoftimi i njerëzve, të cilët e shfrytëzojnë pronën rreth bregut për mbjelljen e kopshteve, të mos e mbjellin më sepse i njëjti do të rregullohet.
15. Rregullimi i gjelbërimit të qytetit.
16. Rregullimit i parkut ekzistues.
17. Rregullimi i gjelbërimit buzë Bulevardit “Makedonia”.
18. Ndotja kimike e tokës dhe ujit.
19. Sistem i kolektorëve.
20. Seleksionimi dhe riciklimi i mbeturinave (plastmasave, qelqit, mbetjeve medicinale dhe llojeve tjera).
21. Kaskada.
22. Diga të vogla.
23. Krijimi i kushteve për shëtitje.
24. Krijimi i kushteve për sport.
25. Mbjellje të sipërfaqeve me lule.
26. Ndërtim të shatërvanit.
27. Mekanizma kontrollues biologjik.
28. Vlera estetike dhe turistike (bukuri të peizazhit dhe natyrës).
29. Ajër të pastër në qendër të qytetit.
30. Ujë të pijshëm për kalimtarët e rastit.
31. Përmirësimi i florës në qendër.
32. Përmirësimi i kontaktit vizual të njerëzve me mjedisin.
33. Vegjetacion më i pasur për ambient bashkëkohor/hortikulturë.
34. Vend më të mirë për pushim dhe rekreacion (shëtitore, kënd për fëmijë dhe ngjashëm).
35. Shtigje të aksesshme nga të gjitha vendet.
36. Ringjallja e diversitetit biologjik.
37. Pasurimi i vlerave/historike dhe fetare.

Si shtojcë: Lista e të pranishmëve

Shembull (nga Dellçeva, është prezantuar në formë integrale):

AXHENDA E GJELBËR”, Mbledhje e grupit “Uji”,

02.04.2008 në ora 12:00

Përmes sublimimit të ideve, nga të gjithë të pranishmit u numëruan funksionet/idetë/propozimet, si dhe çështjet që kanë të bëjnë me ujin, përdorimin dhe mbrojtjen e tij:

1. Uji si pjesë përbërëse e të gjitha organizmave të gjallë dhe nevoja për ujë të pastër.
2. Uji për ujitje.
3. Lumi Bregallnica si mjedis jetësor (peshqit: mustak, mlysh, bojnik, gjuhcë, vidra, bretkosa, gjarpinj, gaforre etj.).
4. Uji i pijshëm për njerëzit (puse).
5. Ndërtimi i një liqeni të vogël me shtrirje prej Qendrës sportive në krah të djathtë të lumit Bregallnicë deri në kaskadë, përkatësisht rregullimi i shtratit në drejtim të urës në zonën qendrore të qytetit. Me këtë do të rritej prurja e ujërave nëntokësore tek pusët, përkatësisht pompat e ujit, ndërkohë që bregu i djathtë do të kultivohet dhe rregullohet, do të begatohet me botë bimore e shtazore, do të shmangen plehërishtat dhe mbeturinat e tjera dhe do të krijohet vend për pushim dhe aktivitete të ngjashme.
6. Ujë i pijshëm (shatërvanë).
7. Lumi Bregallnicë dhe Lumi Grabrovçicë.
8. Argjaturë gome për pamje më të mirë vizuale në zonën qendrore të qytetit.
9. Stacion hidrometeorologjik në Dellçevë, për ndjekjen e rrjedhës së lumit Bregallnicë, analiza dhe kualiteti i ujit nga të gjitha aspektet.
10. Studim për pastrimin e ujërave të zeza.
11. Uji për rekreacion/mundësi për formimin e klubit të kaikeve.
12. Pishinë qyteti.
13. Eksploatimi tej mase i rërës nga lumi çon deri në shkatërrimin e shtratit të lumit.
14. Në çfarë funksioni matës janë instrumentet në rrethin e “Frotirkës”.
15. Rregullimi i shtratit të lumit Bregallnicë me më tepër nivele dhe argjaturë prej gome..
16. Mbrojtje nga vërshimet.
17. Mbrojtja e ujit nga ndotja me ndërtimin e stacioneve të pastrimit për ujëra të zeza dhe ujëra industrial.
18. Ndërtimi i kanalit për lëvizjen e peshqve në raste të ngritjes së digës.

FAZA 3: ANALIZË E DETAJUAR E ÇËSHTJEVE KRYESORE

Qëllimi i kësaj faze është të mblidhen informata të hollësishme për temën në të cilën punohet. Të dhënat duhet të përpunohen dhe të analizohen në mënyrë që të krijohet pasqyrë e qartë për gjendjen momentale të komunitetit dhe tendencat të cilat kanë të bëjnë me vlerat e përcaktuara paraprakisht në të cilat punohen. Një analizë e tillë do të jetë bazë për zgjidhjet që do të definohen.



Njëra nga mbledhjet e anëtarëve të grupit të punës në Vevçan

Në faqen në vijim është dhënë shembull:

Analizë e detajuar e çështjeve kryesore të Komunës së Vevçanit

Hapi	Përshkrimi	Koha e nevojshme	
Tendencat e funksioneve të mjedisit jetësor	Të përkufizohen tendencat kryesore dhe marrëdhëniet ndërmjet tendencave të funksioneve prioritare të zgjedhura (vlerave).	5 mbledhje	
Efektet e tendencave mbi vlerën e cila është objekt	Të vlerësohet efekti social dhe ekonomik i tendencave me qëllim të justifikimit të shkaqeve për arsye të cilave duhet të bëhet diçka.	4 mbledhje	
Krijimi i vizionit dhe vendosja e standardeve minimale	Të përkufizohet vizioni i komunitetit dhe të përcaktohen standardet minimale të cilat çdoherë duhet të respektohen.	5 mbledhje	Nevojitet punë me komunitetin e gjerë për përkufizimin e vizionit.
Përkufizimi i problemeve kryesore	Të përkufizohen problemet dhe përkufizimi të shfrytëzohet si një pikë referimi për përkufizimin e strategjisë për zgjidhjen e problemit.	5 mbledhje	
Analiza e shkaqeve të problemeve	Të përcaktohen shkaqet bazë dhe politikat, të cilat e krijojnë problemin e identifikuar në kuadër të sektorëve të ndryshëm dhe të identifikohen faktorët kryesor përgjegjës dhe mundësitë për ndryshim pozitiv.	6 mbledhje	
Përkufizimi i potencialeve dhe mundësive	Të përkufizohen potencialet kryesore dhe mundësitë si pikë e dytë referimi për përkufizimin e politikave dhe planeve të qëndrueshme.	5 mbledhje	
Përkufizimi i potencialeve prioritare dhe zgjidhjeve	Përkufizimi i prioritetit për pilot-projektet.	2 mbledhje	
Përpilimi i propozim-projektit	Propozim-projekti për realizimin e përkufizimit të prioritetit.	3 mbledhje	

HAPI 4: TENDENCAT E FUNKSIONEVE TË MJEDISIT JETËSOR DHE EFEKTI I TENDENCAVE NË KOMUNITET

Procesi i “Agjendës së Gjelbër” në pilot-komunat në Maqedoni hasi në pengesën e parë gjatë zbatimit të Hapit 4. Në të tria komunat kishte vështirësi në drejtim të përkufizimit të nocion “trend”. Për shkak të përkthimit të paqartë të këtij nocioni u shfaq konfuzion në grupet e punës dhe interpretime të ndryshme të këtij nocioni.

Për sqarimin e këtij nocioni dhe për shmangien e këtyre vështirësive në të ardhmen në vend të nocionit “trend”, ju këshillojmë ta përdorni nocionin “tendencë”, i cili përkon me procesin dhe të njëjtin e përdorim në këtë Manual. Koordinatori i Projektit në mënyrë të qartë duhet tua sqarojë koordinatorëve të grupeve të punës tërë procesin dhe njëherësh tua sqarojë nocionin “tendencë”.

Duhet të shqyrtohen të gjitha dokumentet arkivore deri tek të cilat mund të arrihet që të fitoni një imazh të qartë për tendencat e funksioneve të mjedisit jetësor.

Hapi 4 zhvillohet në grupet e punës dhe pas përfundimit duhet të keni dokument të përpiluar, i cili do t'i përmbajë të gjitha tendencat e funksioneve të mjedisit jetësor.

Hapi 4: Tendencat e funksioneve të mjedisit jetësor dhe efektet e tendencave				
Objektivi : Të përkufizohen tendencat kryesore dhe marrëdhëniet e ndërsjella të tendencave të funksioneve të zgjedhura prioritare nga fusha e mjedisit jetësor.				
Funksioni (Vlera)	Tendenca	Treguesit	Përjashtime pozitive	Efektet e tendencave

Nuk është e thjeshtë të përkufizohen tendencat kryesore dhe marrëdhëniet e ndërsjella të funksioneve të zgjedhura prioritare nga fusha e mjedisit jetësor. Për realizimin e këtij hapi propozojmë që të konsultoheni me trajner, i cili do t'ju ndihmojë që ta realizoni këtë hap.

Nëse në komunën tuaj keni çfarë do qoftë dokumenti strategjik nga fusha e mjedisit mund t'i analizoni që ta realizoni këtë hap.

Me realizimin e këtij hapi do të fitoni një tabelë në të cilën do të radhiten të gjitha tendencat e funksioneve të mjedisit jetësor dhe efektet e tyre.

Pastaj, duhet ta vlerësoni efektin e pritur social dhe ekonomik të tendencave të mjedisit jetësor në mënyrë që të mund ta drejtoni dhe zhvilloni edhe më tej këtë proces.

Hapi 4: Tendencat e funksioneve të mjedisit jetësor dhe efektet e tendencave

Objektivi : Të përkufizohen tendencat kryesore dhe marrëdhëniet e ndërsjella të funksioneve të zgjedhura prioritare nga fusha e mjedisit jetësor.

Funksioni (Vlera)	Tendenca	Treguesit	Përjashtime pozitive	Efektet
Eko-turizmi	Ndotja e rritur e mjedisit për shkak të numrit të shtuar të turistëve.	30 000 vizitorë në nivel vjetor.	Rikonstruksioni i burimeve.	
Uji i pijshëm	Kapaciteti i zvogëluar i burimeve.	Gjatë viteve të fundit janë lidhur 75 objekte të reja në rrjetin ekzistues të ujësjellësit.	Sipas të dhënave nga matjet e Entit për Mbrojtje Shëndetësore në Ohër cilësia e ujit të pijshëm është përmirësuar në 5 vitet e fundit.	
Uji për ujtitje	Tendenca pozitive.	Shfrytëzimi i reduktuar i ujit për ujtitje.	Pjesë e rrjetit të kanaleve për ujtitje është rikonstruktuar dhe kjo rezulton me humbje më të vogla të ujit.	
Monumenti i natyrës	Pozitive	Shpallet si monument i natyrës në RM..	Monumenti i natyrës.	
Mirëmbajtja e burimeve	Negative	Infrastrukturë e amortizuar, erozion i tokës dhe kalbja e infrastrukturës prej druri. Probleme me elektrifikimin.	Rikonstruksion i vogël i një pjese të caktuar të kompleksit të burimeve.	
Efektet e tendencave mbi mjedisin jetësor				
Tendenca (të ndërlidhura në grupe)		Ndikimi social dhe kulturor		Ndikimi ekonomik
Numri i rritur i vizitorëve në Burimet e Vevçanit në 10 vitet		Qarkullimi i rritur i informatave. Nevojë e domosdoshme për		Të ardhura të rritura të qytetarëve, por jo edhe të

e fundit.	mësimin e gjuhës së huaj. Promovohet "Vevçani nëpër Botë".	komunës. Shpenzime të rritura për mirëmbajtje.
Shkatërrimi i infrastrukturës ekzistuese tek burimet		Detyrime të rritura të komunës. Do të reduktohen vizitat turistike.
Erozioni i tokës tek burimet (në lokacione të caktuara)		
Numër i rritur i shfrytëzuesve të ujit.		
Përmirësimi i cilësisë së ujit për pije në 5 vitet e fundit. Të dhënat janë nga Enti për Mbrojtje Shëndetësore-Ohër, i cili në çdo dy javë e bën analizën e ujit.	Përmirësimi i cilësisë së jetës. Reduktimi i problemeve shëndetësore.	
Shfrytëzim i reduktuar i ujit nga Burimet për ujitjen e tokës bujqësore.	Urbanizimi i Vevçanit	Reduktimi i të ardhurave dhe potencialit të punës. Migrim në komunat fqinje ose në komuna tjera.

Shembull:

Hapi 4: Tendencat e funksioneve të mjedisit jetësor dhe efektet e tendencave			
Objektivi : Të përkufizohen tendencat kryesore dhe marrëdhëniet e ndërsjella të tendencave të funksioneve të zgjedhura prioritare nga fusha e mjedisit jetësor.			
Funksioni (Vlera)	Tendenca	Treguesit	Përrjashtime pozitive
Eko-turizëm	Ndotja e rritur e mjedisit për shkak të numrit të shtuar të turistëve.	30 000 vizitorë në nivel vjetor.	Rikonstruksioni i burimeve.
Ujë i pijshëm	Kapacitet i zvogëluar i burimeve.	Gjatë viteve të fundit janë lidhur 75 objekte të reja në rrjetin ekzistues të ujësjetës.	Sipas të dhënave nga matjet e Entit për Mbrojtje Shëndetësore në Ohër, cilësia e ujit të pijshëm është përmirësuar në 5 vitet e fundit.
Ujë për ujitje	Tendenca pozitive.	Shfrytëzim i reduktuar i ujit për ujitje.	Pjesë e rrjetit të kanaleve për ujitje është rikonstruktuar dhe kjo rezulton me humbje më të vogla të ujit.
Monument i natyrës	Pozitive	Shpallet si monument i natyrës në RM.	Monument i natyrës.
Mirëmbajtja e burimeve	Negative	Infrastrukturë e amortizuar, erozion i tokës dhe kalbja e infrastrukturës prej druri. Probleme me elektrifikimin.	Rikonstruksion i vogël i një pjese të caktuar të kompleksit të burimeve.

Shembull:



RAPORT NGA MBLEDHJA ME GRUPIN E PUNËS PËR EKO-QENDRËN (2)

Hapi 4: Tendencat e funksioneve të mjedisit jetësor

Më datë 28.08.2008, në ora 19:00, u mbajt mbledhje me Grupin e punës për Eko-qendrën “VOLVOKS”, në të cilën morën pjesë anëtarët e këtij grupi punues.

Në mbledhje u diskutua për Tendencat e funksioneve të mjedisit jetësor.

Funksionet e mjedisit jetësor	Tendencat	Tregues kryesor/monitorim	Përfashtime pozitive
DIVERSITETI BIOLOGJIK	Tendenca e diversitetit biologjik shënon rënie.	<p>Treguesit kryesor janë: Plani Urbanistik i Komunës së Manastirit dhe Enti i Statistikës. Me regjistrimin e vitit 1991 Manastiri si qytet ka 85 000 banorë, ndërkaq në vitin 2008 numri i banorëve është 120 000.</p> <p>Në malin Baba, rrëqebulli nuk është vërejtur më shumë se 30 vjet.</p> <p>Bëhet një presion i madh mbi mjedisin jetësor me rritjen e numrit të popullsisë dhe me ndërtimin e lagjeve të reja të urbanizuara.</p> <p>Nuk ka institucion i cili do të realizojë edukim joformal dhe bashkëpunim me shkollat, me qëllim që të ndikohet në mënyrën e të menduarit në lidhje me rëndësinë e diversitetit biologjik.</p> <p>Kopshti zoologjik nuk i plotëson rekomandimet për arritjen e standardeve të BE-së për ruajtjen e kafshëve, nuk ka funksion edukues dhe madje as mbrojtje të specieve të rralla nga bota shtazore.</p> <p>Treguesi kryesor është numri i kafshëve të ngordhura dhe kushtet në të cilat jetojnë kafshët.</p> <p>Nuk ka qendra për riprodhim dhe as kopsht botanik.</p>	<p>U përpilua Plani për administrim me Parkun Nacional “Pelister”.</p> <p>Me procesin e decentralizimit, Komuna e Manastirit ndërmerr një sërë aktivitete për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe diversitetit biologjik.</p> <p>Nisma për formimin e Qendrës informative- edukative për zhvillim të qëndrueshëm “VOLVOKS” është pozitive dhe në drejtim të ndryshimit të kahes së tendencës nga negative në më pak negative.</p> <p>Përfashtim pozitiv është interesimi i shkollave fillore që të bashkëpunojnë me “Biosferën” në tema të ndryshme nga fusha e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe natyrës.</p>

FUNKSIONI I BEGATIMIT - KULTURA	Tendenca shënon rritje.	Tregues kryesor është rritja e numrit dhe përmbajtja e evenimenteve kulturore. Manastiri në vitin 2008 u shpall qyteti i kulturës. Filloi përpilimi i Strategjisë për zhvillimin e turizmit në Manastir, në të cilin evenimentet kulturore, monumentet e historisë dhe të kulturës kanë vend të jashtëzakonshëm.	Formohet Shoqatë e grave-artizanale, të cilat i riprodhojnë sendet materiale të kulturës. Hapet Qendra informative turistike. Famullia Ahishte nxit interesimin e vizitorëve.
------------------------------------	-------------------------	--	---

Shembull:



RAPORT NGA MBLEDHJA ME GRUPIN E PUNËS PËR EKO-QENDËR (3)

Hapi 5: Efektet e tendencave të mjedisit jetësor

Më datë 04.09.2008, në ora 19:00, u mbajt mbledhja me Grupin e punës për Eko-qendrën “VOLVOKS”, në të cilën morën pjesë anëtarët e këtij grupi punues.

Në mbledhje u diskutua për efektet e tendencave të funksioneve të mjedisit jetësor dhe veçanërisht nga aspekti i ndikimit të tyre social dhe ekonomik.

Nëse ndryshohet tendenca e zvogëlimit të diversitetit biologjik, kjo mund të ndikojë në zhvillimin e mundësive të veçanta për përmirësimin social dhe ekonomik të gjendjeve të disa grupeve të caktuara vulnerable në shoqëri.

Në këtë kontekst është “Projekti për ndërtimin e qendrës riprodhuese për mbrojtjen e bletës së Mariosës”, i cili zbatohet me mbështetje financiare dhe me partneritet të “Milieucontact Interneshëniell”, FGE – Programi për grante të vogla, Komuna Manastir dhe “Biosfera”, ndërkaq rezultoi nga puna e grupit punues për Eko-qendrën dhe analiza e efekteve nga tendencat e funksioneve të mjedisit jetësor.

Përmes trajnimit për kultivimin e bletëve dhe prodhimin e mjaltit, do të rritet edhe numri i koshareve me bletë të Mariosës, me ç’rast do të kontribuohet në zvogëlimin e efekteve negative të diversitetit biologjik dhe njëkohësisht do të ndikohet mbi përfundimin e gjendjes sociale-ekonomike.

Tendenca pozitive e funksioneve të begatimit – kulturës, ofron mundësi për zhvillim socio-ekonomik përmes punësimeve të reja, në përputhje me mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe principet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Në mbledhje morën pjesë:
(lista e plotë e pjesëmarrësve...)

Shembull:



RAPORT NGA MBLEDHJA ME GRUPIN E PUNËS PËR EKO TURIZËM (2)

Hapi 4: Tendencat e funksioneve të mjedisit jetësor

Më datë 26.08.2008, në ora 18:00, u mbajt mbledhja me Grupin e punës për zhvillimin e eko-turizmit në të cilën morën pjesë anëtarët e këtij grupi punues.

Në mbledhje u diskutua për tendencat e funksioneve të mjedisit jetësor. Si konkluzion nga debati rezultoi se eko-turizmi i bën hapat e parë dhe se me një promovim dhe reklamim adekuat mundet të zhvillohet shumë shpejtë dhe të kontribuojë për ringjalljen e fshatrave në zonën e Manastirit.

Propozime për veprim: bashkëpunimi me shkollat fillore dhe të mesme për organizimin e ekskursioneve; bashkëpunim me shoqërinë e gjuetarëve për përdorimin e automjeteve të tyre për transportin e turistëve; eksplorim të malit Baba nga ana greke Velushina dhe fshatrat përreth; përpunimi internet portalit, në të cilin do të ketë informata për të gjitha pikat e piknikut dhe për atraksionet turistike në Republikën e Maqedonisë.

Funksionet e mjedisit jetësor	Tendencat	Tregues kryesor/monitorimi	Përrjashtime pozitive
FUNKSIONI I BEGATIMIT - KULTURA	Tendenca shënon rritje.	Eko-turizmi shënon rritje dhe një numër më i madh i qytetarëve kërkojnë forma të organizuara të praktikimit të formave të ndryshme të eko-turizmit dhe shëtitjes në natyrë. U hap Qendra informative turistike. Filloi përpilimi i Strategjisë për turizmin në Komunën e Manastirit.	U formua Shoqata e grave –artizanale, të cilat i riprodhojnë sendet materiale të kulturës. Famullia Ahishte nxiti interesimin e vizitorëve.

Shembull:



RAPORT NGA MBLEDHJA ME GRUPIN E PUNËS PËR UJË (2)

Hapi 4: Tendencat e funksioneve të mjedisit jetësor

Më datë 27.08.2008, në ora 19:00, u mbajt mbledhja me Grupin e punës për mbrojtjen e ujërave.

Temë diskutimi ishin tendencat e funksioneve të mjedisit jetësor.

U sugjerua se si rezultat e ndryshimeve klimatike dhe shfrytëzimit joracional të ujërave, të njëjtit janë zvogëluar në masë të konsiderueshme.

Propozime për veprim: edukimi nëpër shkolla, eko-radio-emisione, apele drejtuar autoriteteve që të ndërmarrin masa për përmirësimin e gjendjes.

Funksionet e mjedisit jetësor	Tendencat	Tregues kryesor/monitorimi	Përfundime pozitive
FUNKSIONI PRODHUES PRIMAR	Reduktimi i sasisë dhe cilësisë së ujit të pijshëm.	Sistem i amortizuar i ujësjellësit. Ndryshimet klimatike, reduktimi i sasisë së reshjeve të borës. Shfrytëzim joracional nga ana e popullatës. Përdorimi i ujit të pijshëm për ujitje. Rritja e numrit të popullsisë dhe nevoja për sasi më të mëdha.	Nisma nga shoqatat e qytetarëve për ta kursyer ujin. Interesim nga Ndërmarrja Publike "Ujësjellës" përmes reklamave me video-klipe të ndikojë në ndërgjegjësimin e qytetarëve.

Në mbledhje morën pjesë:

- Ruzha Petrova,
- Marija Petkovska,
- Sashko Naumov,
- Aleksandra Stojanovska,
- Jovanovski Darko,
- Julijana Strezovska,
- Remzi Medik,
- Lina Petkovska,
- Neshad Azemovski,
- Dragan Jankoski,
- Dimitar Egumenovski,
- Emilian Dimitrovski.

HAPI 5: EFEKTI I TENDENCAVE TË MJEDISIT JETËSOR

Për këto çështje përkatësisht për temat prioritare që i përzgjedh komuniteti në grupet e punës mbahen diskutime të hollësishme.

Objektivi:

Të vlerësohet efekti i dëshiruar social dhe ekonomik i tendencave të mjedisit jetësor me qëllim të arsyetimit të motiveve për shkak të të cilëve duhet të ndërmerret diçka.

Vërejtje:

Për t'u bërë diçka në drejtim të tendencave të mjedisit jetësor nevojiten angazhime dhe investime. Domethënë, duhet qartë të arsyetohet motivi për një investim të këtillë. Ç'do të ndodhë nëse nuk ndërmerret asgjë? Nevojitet një vlerësim i tendencave aktuale të vlerave shoqërore dhe ekonomike për grupet e ndryshme të interesit. Si do të ndikojë kjo mbi ata nëse vazhdon tendenca, ndërkohë që nuk ndërmarrim asgjë në lidhje me këtë çështje? Dritarja nr. 6 jep disa vlera të përgjithshme që mund të shfrytëzohen për vlerësimin e ndikimit të ndryshimit të mjedisit jetësor.

Shembull:



RAPORT NGA MBLEDHJA ME GRUPIN E PUNËS PËR EKO-TURIZËM (3)

Hapi 5: Efektet e tendencave të mjedisit jetësor

Më datë 02.09.2008, në ora 18:00, u mbajt mbledhja me Grupin e punës për zhvillimin e eko-turizmit, në të cilën morën pjesë anëtarët e këtij grupi punues.

Në mbledhje u diskutua për efektet e tendencave të mjedisit jetësor. Si konkluzion në këtë mbledhje u konstatua se zhvillimi i eko-turizmit shënon rritje, ndërkohë me punë, hulumtime dhe investime në këtë segment mund të arrihen rezultate të shkëlqyeshme.

Ekziston rreziku i dukurisë së masivitetit me ç'rast mjedisi jetësor do pësojë presione dhe ndotje të caktuara dhe kështu tendenca nga arritjet pozitive do të kalojë në negative.

Gjatë punës vazhdimisht duhet të theksohet balancimi ndërmjet numrit të vizitorëve, infrastrukturës dhe kapacitetit për qëndrueshmërinë e eko-sistemit.

Në mbledhje morën pjesë:

Aleksandra Stojanovska,
Nikolçe Nikolovski,
Romeo Micevski,
Katerina Mavrovska,
Meri Bandevska,
Neshad Azemovski.

HAPI 6: KRIJIMI I VIZIONIT DHE VENDOSJA E STANDARDEVE MINIMALE

Objektivi: Të përkufizohet vizioni i komunitetit, në rastin ideal, i përbashkët për të gjitha palët e interesuara dhe të përcaktohen standarde minimale të cilat çdoherë duhet respektuar.

Për realizimin e këtij hapi dhe për arritjen e rezultateve të dëshiruara, duhet me sukses të kryhet hapi paraprak dhe sipas rezultateve të fituara për tendencat e secilës vlerë të vendosen standardet minimale për secilën veç e veç.

Me standarde minimale nënkuptohet kufiri minimal i poshtëm nën të cilin vlera në fjalë nuk guxon të bie.

Shembull: Pastërtia e ujit të pijshëm: standard minimal – 2 kategoria e pastërtisë.

Përshkrimi: Ky hap, nëpër grupet e punës duhet të përpunohet në mënyrë të hollësishme. Kompleksiteti i këtij hapi imponon që puna të ndahet në disa mbledhje dhe fillimisht të punohet në krijimin e vizionit dhe pastaj të vendosen standardet minimale. Kjo, hollësisht përpunohet në grupet e punës dhe paraqet një punë komplekse e cila duhet të punohet me kujdes meqë në bazë të parametrave që do të rezultojnë nga ky hap do të krijohen bazat e Planit strategjik të “Axhendës së Gjelbër”.

Vizioni – krijimi i vizionit duhet të përgatitet në mbledhje të përbashkët me të gjitha grupet e punës. Për krijimin e vizionit nevojiten disa mbledhje.

Secili grup i punës duhet të përgatis një prezantim të shkurtër mbi punën e deritanishme, me ç’rast do të apostrofohen tendencat pozitive dhe të dhënat e grumbulluara gjatë punës.

Kjo bëhet me qëllim që më lehtë të krijohet vizioni dhe të shkëmbehen informata ndërmjet grupeve të punës.

GJATË PERIUDHËS SË PUNËS NËPËR GRUPE PUNUESE NË VEVÇAN, MBLEDHJET E TË TRIJA GRUPEVE U MBAJTËN BRENDA NJË DITE, ME 30 MINUTA PUNË TË PËRBASHKËT, PËR SHKËMBIMIN E TË DHËNAVE DHE MENDIMEVE.

Mënyra e këtillë e punës rezultoi mjaft efikase dhe ndihmoi në punën e mëtutjeshme dhe në përpilimin e dokumentit të “Axhendës së Gjelbër”.

Shembull (nga Vevçani):

Hapi 6: Krijimi i vizionit dhe vendosja e standardeve minimale

Objektivi: Të përkufizohet vizioni i komunitetit. Në rastin ideal ai duhet të jetë i përbashkët për të gjitha vlerat e zgjedhura. Gjithashtu, duhet të përcaktohen edhe standardet minimale të vlerave, të cilat çdoherë duhet të respektohen.

Vizioni: Burimet e Vevçanit-atraksion turistik me ujë të pastër të pijshëm dhe me kapacitet prej 4000 l/sek ujë të pastër të pijshëm.

Kritere për vizion të qartë dhe të realët:

Ruhet niveli i ujit të pastër.

Shenja emblematike e Vevçanit - brend për promovim në Botë.

Qytetarët edhe në të ardhmen të kenë ujë të pastër për pije.

Rritja e të ardhurave të komunës.

Shembull (nga Manastiri):



RAPORT NGA MBLEDHJA ME GRUPIN E PUNËS PËR EKO-QENDËR (4)

Hapi 6: Krijimi i vizionit dhe vendosja e standardeve

Më datë 11.09.2008, në ora 19:00, u mbajt mbledhja me Grupin e punës për Eko-qendrën “VOLVOKS”, në të cilën morën pjesë anëtarët e këtij grupi punues.

Në mbledhje u diskutua për **krijimin e vizionit dhe vendosjen e standardeve minimale.**

Vizioni: Qendra informative-edukative për zhvillim të qëndrueshëm “VOLVOKS” është institucion bashkëkohor i cili gjeneron ndryshime pozitive shoqërore, në nivel lokal dhe rajonal, përmes promovimit dhe zbatimit të principeve për zhvillim të qëndrueshëm.

Metodat dhe veglat që do të përdoren në procesin e planifikimit:

- transparenca;
- objektiviteti;
- pavarësia;
- përfshirja e barabartë e të gjithëve;
- përfshirja e ekspertëve dhe konsulentëve në fazën e planifikimit (arkitekt dhe ekspert i kompjuterëve për animacion 3D).

Mënyra e zgjidhjes së konflikteve: Kanë rënë dakord që nëse shfaqen konflikte ato të zgjidhen me mjete paqësore dhe pa dhunë, përmes dialogut dhe bisedave të ndërsjella. Nëse nuk ekziston zgjidhje pa përdorimin e dhunës, konflikti hidhet poshtë dhe për të njëjtin nuk diskutohet më. Vazhdohet me ide dhe kahe tjetër.

Anë të forta:

- motivimi dhe dëshira për punë;
- përfshirja e mediave në procesin e “Axfordës së Gjellbër” “;
- përvojat e qendrave të ngjashme në Gjermani dhe Francë;
- partneritet i vendosur me organizatën ANU nga Hamburgu i Gjermanisë;
- interesim për bashkëpunim nga pushteti lokal;
- metodologjia e “Axfordës së Gjellbër” përmes së cilës vendoset kahja e mirëfilltë e veprimit.

Anë të dobëta:

- mospasja e mjeteve financiare për të gjitha përmbajtjet e planifikuara.

Mundësitë:

- krijimi i planit për sigurimin e mjeteve financiare.

Sfidat:

- përpilim i planit hapësinor me përmbajtjet e “Volvoks”-it;
- përpunimi i animacionit 3D me prezantimin e vizionit të grupit të punës.

Standardet minimale: “Volvoks” punon në nivel lokal komunal në bashkëpunim me shkollat fillore dhe të mesme.

Standardet maksimale: “Volvoks”, përveç punës në nivel lokal, promovohet edhe në planin ndërkombëtar dhe zbaton aktivitete me karakter global me pjesëmarrje ndërkombëtare.

Shembull (nga Manastiri):



RAPORT NGA MBLEDHJA ME GRUPIN E PUNËS PËR EKO-TURIZËM (4)

Hapi 6: Krijimi i vizionit dhe vendosja e standardeve minimale

Më datë 12.09.2008, në ora 18:00, u mbajt mbledhja me Grupin e punës për zhvillimin e eko-turizmit, në të cilën morën pjesë anëtarët e këtij grupi punues.

Në mbledhje u diskutua për krijimin e vizionit dhe për vendosjen e standardeve minimale.

Vizioni: Manastiri ka një infrastrukturë të zhvilluar për zbatimin e eko-turizmit, qytetarët janë të informuar dhe të edukuar, ndërsa lëvizjet e tyre në natyrë shënojnë rritje. Si rezultat i kësaj janë hapur vende të reja pune.

Standarde minimale: infrastrukturë mirë e zhvilluar – kosha për plehra, stole, shtigje etj.

Është konstatuar se zbatimi i formave të eko-turizmit do të ndikojnë pozitivisht në mirëqenien e qytetarëve nga më shumë aspekte.

Në mbledhje morën pjesë:

(lista e pjesëmarrësve...)

Shembull (nga Manastiri):



RAPORT NGA MBLEDHJA ME GRUPIN E PUNËS PËR UJË- (4)

Hapi 6: Krijimi i vizionit dhe vendosja e standardeve minimale

Më datë 17.09.2008, në ora 19:00, u mbajt mbledhja me Grupin e punës për mbrojtjen e ujërave. Në mbledhje morën pjesë anëtarët e këtij grupi punues.

Temë e diskutimit ishte krijimi i vizionit dhe vendosja e standardeve minimale.

Edhe paraprakisht kishte sugjerime se ballafaqohemi me një problem mjaft të madh të ndotjes së ujërave të pijshëm nga Pelisteri, si rezultat i sistemit joadekuat për shkarkim të Hotelit “Molika”. Nga autoritetet lokale u propozua që përmes fushatës mediatike të iniciohet zgjidhja e këtij problemi, me çka do të kontribuohet në mbrojtjen e ujërave.

Vizioni: Qytetarët janë të ndërgjegjshëm për rëndësinë e ujit si resurs dhe i ndryshuan shprehitë e tyre në drejtim pozitiv, duke e kursyer dhe duke ia ditur vlerën ujit të pijshëm.

Standarde minimale: fushata për kursimin e ujit, punëtori dhe edukim joformal nëpër shkolla, si dhe radio-emisione me mesazhe pozitive.

Në mbledhje morën pjesë:

Ruzha Petrova, Marija Petkovska, Sashko Naumov, Aleksandra Stojanvoska, Darko Jovanovski, Juliana Strezovska, Remzi Medik, Lina Petkovska, Neshat Azemovski, Dragan Jankoski, Dimitar Egumenovski dhe Emilia Dimitrovska.

HAPI 7: PËRKUFIZIMI I PROBLEMEVE KRYESORE TË VLERAVE (MJEDISI JETËSOR)

Objektivi: Të përkufizohen problemet kryesore të vlerave (mjedisi jetësor) dhe përkufizimi të përdoret si pikë referimi për përcaktimin e Strategjisë për zgjidhjen e problemit.

Përshkrimi: Mbledhje për përcaktimin e problemeve të cilat do të rezultojnë nga krahasimi i të dhënave të fituara nga hapat paraprak dhe nga vizioni i përcaktuar.

Problemet kryesore do t'i përkufizoni aty ku tendencat çojnë në drejtim të rrezikut të papranueshëm, e tejkalojnë kufirin e standardeve minimale ose kur pritet që një gjë e tillë të ndodh në të ardhmen. (Duhet të parashikohen kanosjet e mundshme ndaj funksioneve prioritare të vlerave).

Pasi të përkufizohen problemet (nevojitet përkufizim i përpiktë i problemit), bëni një analizë të palëve të interesuara për këtë problem dhe cekini rreziqet që mund të rezultojnë nga problemi.

Vlera	Tendenca	Problemi	Urgjenca	Rreziku	Palë të interesuara

Shembull (nga Vevçani):

Hapi 7: Përkufizimi i problemeve kryesore të mjedisit jetësor	
Objektivi: Të përkufizohen problemet kryesore të mjedisit jetësor dhe përkufizimi të përdoret si pikë referimi për përcaktimin e Strategjisë për zgjidhjen e problemeve.	
Përkufizimi i problemit (në rastet kur tendencat çojnë në drejtim të rrezikut të papranueshëm)	
Turizëm masiv – që shënon rritje në 10 vitet e fundit	
Kriteret	Rëndësia e problemit të identifikuar
Lokaliteti	Komuna e Vevçanit
Palët e interesuara	Qytetarët e Vevçanit
Faktorët përgjegjës	Komuna e Vevçanit, NPK
Urgjenca	Matjet tregojnë se cilësia e ujit është e mirë, por se duhet të mbrohet si standard minimal deri në cilën shkallë mund të ndotet.

Tendencat kryesore	Nuk ka mekanizma për mbrojtjen e Burimeve. Nuk ka strategji për administrimin dhe për mirëmbajtjen e kompleksit në tërësi.
Pasojat aktuale dhe rreziqet e pritshme mbi shoqërinë	Ndotja vizive e Burimeve.

Vlera	Tendenca	Problemi	Urgjenca	Rreziku	Palë të interesuara
Burimet e Vevçanit	Interesim i shtuar i vizitorëve për Burimet e Vevçanit.	Numër i madh i vizitorëve të Burimeve. Nuk ka kurrfarë mbrojtje të njëjtëve e as mjete financiare për mbrojtje dhe mirëmbajtje.	Problem më urgjent për zgjidhje.	Uji i pijshëm në Vevçan mund të ndotet.	I tërë komuniteti.

Shembull (nga Manastiri):



RAPORT NGA MBLEDHJA ME GRUPIN E PUNËS EKO-QENDËR (5)

Hapi 7: Përkufizimi i problemeve kryesore të mjedisit jetësor

Më datë 18.09.2008, në ora 19:00, u mbajt mbledhja me Grupin e punës për Eko-qendrën “VOLVOKS”, në të cilën morën pjesë anëtarët e këtij grupi punues.

Në mbledhje u diskutua për përkufizimit e problemeve kryesore të mjedisit jetësor.

Objekt i interesimit të grupit të punës ishte Qendra informative-edukative dhe problemet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor.

Problemi: Ndikimi negativ i mbipopullimit njerëzor ndaj mjedisit jetësor si rezultat i informimit dhe edukimit të pamjaftueshëm, si dhe zbatimit të pamjaftueshëm të normave ligjore dhe, po aq i rëndësishëm, mosekzistimit të një qendre edukative informative përmes punës të së cilës do të ndikohet në ndërgjegjësimin e popullsisë së përgjithshme

me anë të edukimeve dhe fushatave dhe përmes ndikimit mbi pushtetin lokal dhe qendror për zbatimin e kornizës ligjore.

Kriteret	Domethënia e problemit të identifikuar
Lokaliteti:	-Qendra informative-edukative do të vendoset në lokacion të shkëlqyeshëm në Lagjen “Lavçanska”, rreth 400 metra larg rrugës së asfaltuar në drejtim të malit. Në një distancë prej rreth 1 km, ka transport publik urban. Ka rrugë të aksesshme për qarkullimin e automjeteve, me çka edhe personave me nevoja të veçanta u mundësohet pjesëmarrja në një pjesë të punëve.
Palë të interesuara:	shkollat fillore dhe të mesme; Fakulteti për Bioteknologji; pushteti lokal; popullsia lokale; publiku i gjerë; shoqëritë ekologjike; turistët, dhe punonjësit shkencorë.
Faktorë përgjegjës:	pronarët e tokës; „Biosfera“; anëtarët e grupit të punës; pushteti lokal.
Urgjenca:	Në lidhje me urgjencën është rënë dakord se punët duhet të intensifikohen në mënyrë që të shfrytëzohet koha për aftësimin sa më të shpejtë dhe fillimin me punë.
Tendenca kryesore:	Kjo është nisma e parë e këtij lloji në Republikën e Maqedonisë. Tendencën e kthimit kah natyra dhe mënyrën e shëndetshme të të ushqyerit e imponon nevoja për ekzistimin dhe funksionimin e një institucioni të këtillë.
Pasojat aktuale dhe rreziku i pritshëm ndaj shoqërisë:	Pasojat janë pozitive dhe do të gjenerojnë ndryshime pozitive në shoqëri në drejtim të zbatimit të principeve të zhvillimit të qëndrueshëm.

Zgjidhja: Krijimi i Qendrës informative-edukative, e cila do të ketë një bashkëpunim intensiv me shkollat fillore dhe të mesme.

Shembull (nga Manastiri):



RAPORT NGA MBLEDHJA ME GRUPIN E PUNËS PËR EKO-TURIZËM (5)

Hapi 7: Përkufizimi i problemeve kryesore të mjedisit jetësor

Më datë 16.09.2008, në ora 18:00, u mbajt mbledhja me Grupin e punës për zhvillimin e eko-turizmit, në të cilën morën pjesë anëtarët e këtij grupi punues.

Në mbledhje u diskutua lidhur me përkufizimin e problemeve kryesore të mjedisit jetësor. Si probleme kryesore u apostrofuan popullimi i vogël i zonave në të cilat mund të zhvillohet eko-turizmi, me ç'rast për momentin paraqitet edhe problemi i mosekzistimit të kapaciteteve akomoduese.

Propozime për veprim: promovimi i eko-turizmit si mundësi e ringjalljes së zonave rurale; adaptimi i konakëve të manastireve rurale si kapacitete akomoduese.

Një problem tjetër i rëndësishëm është edhe sjellja e pandërgjegjshme dhe e paligjshme e njerëzve - vizitorë të natyrës.

Nuk ka edukim dhe fushatë për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor dhe natyrës.

Hapi 8: Analiza e shkaqeve për problemet kryesore të mjedisit jetësor

Si shkak më i rëndësishëm për të cilin duhet të mendohet është niveli skajshëm i ulët i zbatimit të normave ligjore dhe dispozitave ndëshkuese.

Duhet të lobohet tek autoritetet lokale dhe qendrore me qëllim të përmirësimit të punës së shërbimeve inspektuese dhe në mënyrë konsekuente të zbatohet ligji ndaj kundërvajtësve.

Në mbledhje morën pjesë:

Aleksandra Stojanovska, Nikollçe Nikollovski, Romeo Micevski, Katerina Mavrovaska, Meri Bandevska, Neshat Azemovski.

Shembull (nga Manastiri):



RAPORT NGA MBLEDHJA ME GRUPIN E PUNËS PËR UJË (5)

Hapi 7: Përkufizimi i problemeve kryesore të mjedisit jetësor

Më datë 17.09.2008, në ora 19:00, u mbajt mbledhja me Grupin e punës për mbrojtjen e ujërave.

Temë e diskutimit ishte përkufizimi i problemeve kryesore të mjedisit jetësor.

Si probleme kryesore u apostrofuan ndotja e ujërave nëntokësore në Pelister dhe ndotja e liqenit artificial “Strezhevo” dhe shkarkimi i pakontrolluar i ujërave nga akumulimet.

Problemi kryesor është sjellja e pandërgjegjshme e qytetarëve, përkatësisht faktori njeri, ndryshimet klimatike dhe shtimi i numrit të popullsisë që ka nevojë për ujë të pijshëm.

Hapi 8: Analiza e shkaqeve të problemeve kryesore të mjedisit jetësor

Njerëzit sillen në mënyrë të pandërgjegjshme si rezultat i moszbatimit të ligjit dhe masave ndëshkuese të parashikuara për kundërvajtësit.

Shtimi i popullsisë është rezultat i migracionit të rritur fshat-qytet.

Shkaqet e ndryshimeve klimatike janë të njohura botërisht.

Në mbledhje morën pjesë:

- Ruzha Petrova,
- Maria Petkovska,
- Sashko Naumov,
- Aleksandra Stojanovska,
- Juliana Strezovska,
- Neshad Azemovski,
- Drgan Jankoski,
- Emilia Dimitrovska.

HAPI 8: ANALIZA E SHKAQEVE TË PROBLEMEVE

Objektivi:

Të përcaktohen faktorët dhe politikat që e krijojnë problemin e konstatuar në kuadër të sektorëve të ndryshëm dhe të identifikohen shkaqet kryesore të problemit, si dhe mundësitë e ndryshimeve pozitive.

Përshkrimi:

Të gjitha problemet që shfaqen, në hapin paraprakisht të përfunduar, i kanë motivet e tyre të cilat duhet të përcaktohen dhe shqyrtohen me këtë hap. Këtu duhet bërë një analizë dhe thellë të mendohet për shkaqet e shfaqjes së problemeve. Të gjitha shkaqet e identifikuar të problemit doemos duhet të analizohen dhe në mënyrë të caktuar të klasifikohen me qëllim që të konceptohet strategjia për zgjidhjen e tij.

Për t'i analizuar shkaqet e problemit do t'ju ndihmojnë të gjitha të dhënat e grumbulluara paraprakisht, si dhe të gjitha dokumentet që i keni siguruar si grup pune. Analiza e dokumenteve ekzistuese brenda komunitetit do t'ju ndihmojë që me sukses ta përfundoni këtë hap. Medoemos duhet ta keni parasysh atë se shkaqet e problemit mund të jenë komplekse, të përbërë nga më shumë faktorë, të cilët kanë ndikim të përbashkët dhe e krijojnë problemin. Me këtë analizë përfshihet çdo aspekt i problemit dhe çdo faktor që ka ndikim: faktori njeri, politikat lokale ose nacionale, ekonomia, faktorët ndërkombëtarë, marrëveshjet ndërshtetërore etj. Të gjithë këta faktorë duhet të diferencohen në mënyrë që të fitohet një imazh i qartë për shkaqet e problemit dhe së këtejmi të gjendet strategjia më e mirë për zgjidhjen ose parandalimin e të njëjtit.

Problemi: _____					
Urgjenca dhe rreziku					
	Faktorët shoqërorë:	Faktorët ekonomikë (institucione ose individë)	Faktorët institucional (institucione ose individë)	Faktorët e mjedisit jetësor	Faktorë të pa-kategorizuar
Niveli lokal					
Niveli nacional					
Niveli ndërkombëtar					

Në qoftë se në këtë mënyrë i radhisni faktorët e shkakut të problemit do të keni një pasqyrë të qartë për rëndësinë e problemit dhe për kompleksitetin e zgjidhjes të cilën duhet ta gjeni. Në këtë mënyrë do ta shqyrtoni procedurën për miratimin e vendimeve në nivele të ndryshme të pushtetit dhe hapat e këtillë do të duhet t'i ndërmerri në mënyrë që të arrini deri te rezultati i dëshiruar. Shpeshherë ndodhë që në shikim të parë problemi të duket i vogël, por për shkak të kompleksitetit të faktorëve të cilët kanë ndikim mbi motivin kryesor të problemit, të kenë ndikim të madh mbi procesin dhe ta kuptoni se zgjidhja nuk do të jetë as e shpejtë e as e thjeshtë. Analiza e shkaqeve të problemeve do t'ju ndihmojë që të keni një pasqyrë të qartë në lidhje me sfidat të cilat qëndrojnë para jush për zgjidhjen e problemeve të caktuara, të cilët paraqesin kanosje reale për vlerat për të cilat angazhoheni.

Hapi 8: Analiza e shkaqeve të problemeve				
Objektivi: Të përcaktohen shkaqet kryesore dhe politikat që e krijojnë problemin e identifikuar në kuadër të sektorëve të ndryshëm dhe të përkufizohen faktorët kryesorë dhe mundësitë për ndryshime pozitive.				
Problem i përcaktuar				
Niveli				
Shkaqet konkrete të problemit dhe pjesëmarrësit që kanë të bëjnë me të dhe mundësitë që mund të ndihmojnë në zgjidhjen e problemit në dimensione të ndryshme dhe nivele të ndryshme.				
	Faktorë shoqërorë + pjesëmarrës	Faktorë ekonomikë + pjesëmarrës	Faktorë institucionalë + pjesëmarrës	Faktorë të mjedisit jetësor
Lokal	Për shembull, mungesa e njohurive tek popullsia lokale etj.	Për shembull, pronarët lokal të pyjeve shpeshherë janë të varfër etj.	Për shembull, mungesa e programit për administrim me pyjet private etj.	Për shembull, rritja e nivelit të ajrit të ndotur, rritja e erozionit etj.
Nacional	Nuk ka edukim nëpër shkolla, ndërgjegje e ulët për administrim me pyje etj.	Nuk ka strategji shtetërore ose programe për administrimin e pyjeve private etj.	Moszbatimi i ligjeve, ndarja e paqartë e përgjegjësisë, nuk ka organizim të pronarëve etj.	Varfërimi i resurseve pyjore nacionale, etj.
Ndërkombëtar				
Aktivitete, faktorë		Për shembull, prerja informale e pyjeve private në Maleshevi.		

Problemi	Për shembull, zvogëlim i rezervave pyjore, reduktim i prodhimit të oksigjenit, nuk ka kontroll të erozionit, nuk ka ujë të pastër etj.
Zgjidhje	Për shembull, edukimi i sipërmarrësve privat, sigurimi i mënyrës së qëndrueshme të financimit të zhvillimit të programeve për administrim me pyjet, përcaktim i qartë i përgjegjësive etj.

HAPI 9: PËRKUFIZIMI I POTENCIALEVE DHE MUNDËSIVE

Objektivi:

Të përkufizohen potencialet dhe mundësitë kryesore të mjedisit jetësor, si pikë e dytë referimi për përkufizimin e planeve dhe politikave të qëndrueshme të mjedisit jetësor.

Përshkrimi:

Grupet e punës t'i përcaktojnë dhe t'i apostrofojnë të gjitha potencialet dhe mundësitë brenda komunitetit, që rezultojnë nga vlera në të cilën punojnë. Në këtë drejtim mund të ndihmojë përkufizimi i vizionit dhe standardeve minimale. Gjithsesi, potencialet dhe mundësitë duhet të jenë reale dhe të korrespondojnë me kohën e dhënë për përmbushjen e vizionit.

Vlera	Potenciali/mundësia	Standardi/vizioni	Vërejtje

Hapi 9: Përkufizimi i potencialeve dhe mundësive	
Objektivi: Të përkufizohen potencialet dhe mundësitë kryesore të mjedisit jetësor, si pikë referimi për përkufizimin e planeve dhe politikave të qëndrueshme të mjedisit jetësor.	
Potencialet	Mundësitë
Kompleksi i Burimeve të Vevçanit, mali Jabllanicë, një numër i madh i kishave dhe manastireve.	Zhvillimi i llojeve të ndryshme të turizmit, sipas potencialeve të komunitetit. Edukimi i popullsisë në lidhje me potencialet dhe vlerat e Vevçanit.



Anëtarët e grupeve të punës nga Vevçani dhe Manastiri morën pjesë në evenimentin tradicional “Dasma planece e Maleshevisë” në Dellçevë, shtator, viti 2008

Shembull (nga Manastiri):



RAPORT NGA MBLEDHJA ME GRUPIN E PUNËS PËR EKO-QENDËR (6)

Hapi 9: Përkufizimi i problemeve kryesore të mjedisit jetësor

Më datë 02.10.2008, në ora 19:00, u mbajt mbledhja me Grupin e punës për Eko-qendrën “VOLVOKS”, në të cilën morën pjesë anëtarët e këtij grupi punues.

Në mbledhje u diskutua për përkufizimin e potencialeve dhe mundësive. Pas diskutimit, në këtë mbledhje, u nxor konkluzioni se me ndërtimin e Eko-qendrës hapet mundësia për punësime të reja, si dhe mundësia për rritjen e nivelit të njohurive tek fëmijët, me çka do të kontribuohet në drejtim të ruajtjes dhe avancimit të mjedisit jetësor.

Potencialet	Mundësitë
Fitimi i njohurive:	-edukimi joformal për zhvillim të qëndrueshëm;
	-hulumtimi;
Rekreacioni:	-shëtitje me biçikletë;
	-shëtitje në këmbë;
	-alpinizëm;
	-sport.
Përmirësimi i gjendjes sociale-ekonomike:	-përvetësimi i zejeve të reja për përpunimin e suvenireve me materiale natyrore dhe ngjashëm;
	-rritja e bletëve dhe prodhimi i mjaltit;
	-ruajtja e traditës së zejeve të vjetra.
Kushte të mira klimatike, tokë e pandotur:	-kultivimi i ushqimit organik dhe shitja e të njëjtit;
	-kultivimi i luleve;
	-mbjellja e varieteteve të caktuara të bimëve.

Në mbledhje morën pjesë:

- Hristo Dimitrovski,
- Toni Stojçevski,
- Lidia Petrova
- Boris Jagoridovski,
- Samedin Kananovski,
- Aleksandra Stojanovska,
- Neshat Azemovski.

Shembull (nga Manastiri):



RAPORT NGA MBLEDHJA ME GRUPIN E PUNËS PËR EKO-TURIZËM (6)

Hapi 9: Përkufizimi i potencialeve dhe mundësive

Më datë 30.09.2008, në ora 18:00, u mbajt mbledhja me Grupin e punës për zhvillimin e Eko-turizmit në të cilën morën pjesë anëtarët e këtij grupi punues.

Në mbledhje u diskutua për përkufizimin e potencialeve dhe mundësive. Konkluzioni ishte se ekzistojnë potenciale dhe mundësi të mëdha për zhvillimin e eko-turizmit në zonën e Manastirit, para së gjithash në lokalitetin e Famullisë Ahishte.

Potencialet	Mundësitë
Ndërtim i shtigjeve për rekreacion:	-rritja e lëvizjes së qytetarëve;
	-përmirësimi i shëndetit të qytetarëve;
	-shëtitje me biçikletë;
	-shëtitje në këmbë;
	-alpinizëm;
Përmirësim i gjendjes sociale-ekonomike:	-sport.
	-përvetësimi i zejeve të reja për përpunimin e suvenireve me materiale natyrore dhe ngjashëm;
	-rritja e bletëve dhe prodhimi i mjaltit;
Kushte të mira klimatike, tokë e pandotur:	-ruajtja e traditës së zejeve të vjetra.
	-mundësi për zhvillimin e turizmit rural;
	-mundësi për zhvillimin e agro-turizmit dhe gjenerimin e të ardhurave plotësuese të qytetarëve;

Shembull (nga Manastiri):



RAPORT NGA MBLEDHJA ME GRUPIN E PUNËS PËR UJË (6)

Hapi 9:Përkufizimi i potencialeve dhe mundësive

Më datë 01.10.2008, në ora 19:00, u mbajt mbledhja me Grupin e punës për mbrojtjen e ujërave.

Temë diskutimi ishte përkufizimi i potencialeve dhe mundësive.

Fushatë për mbrojtjen dhe kursimin e ujit të pijshëm dhe mbrojtja e resurseve ujore.

Potencialet	Mundësitë
Ndërtimi i zonës rekreative në lumin e Dihovës:	-rritja e lëvizjes së qytetarëve;
	-përmirësimi i shëndetit të qytetarëve;
	-shëtitje me biçikletë;
	-shëtitje në këmbë;
	-alpinizëm;
Përmirësimi i gjendjes sociale-ekonomike:	-sport.
	-mundësi për vende të reja pune;
	-gjenerimi i të ardhurave nga prezantimi i bukurive natyrore të lumit;
Kursimi i ujit të pijshëm dhe mbrojtja e resurseve ujore:	- gjenerimi i të ardhurave përmes ndërtimit të basenit për peshq për koranin endemik të Pellagonisë.
	- fushata edukative;
	- punëtori me nxënës;
	- aksione për pastrimin e shtretërve të lumenjve nga mbeturinat.

HAPI 10: PËRKUFIZIMI I POTENCIALEVE PRIORITARE DHE ZGJIDHJET

Objektivi:

Përmes kontrollit të kriterëve për qëndrueshmëri, si dhe përmes kriterëve të tjera të cilat do t'i përcaktojnë anëtarët e grupeve të punës, të përcaktohet cilët potenciale, mundësi dhe politika janë më të dëshiruara dhe më së shumti premtojnë në komunitet.

Atje ku është e mundur të përkufizohen opsionet me të cilat të gjithë fitojnë (Win-Win), përkatësisht opsione me efekte pozitive mbi mjedisin jetësor dhe mbi zhvillimin, gjegjësisht opsione të atilla që kanë efekt pozitiv edhe në sytë e palëve të interesuara edhe mbi aktivitetet të cilat në afat të shkurtër japin rezultate të dukshme pozitive.

Të përkufizohen opsionet që e ndihmojnë zhvillimin e komunitetit por njëkohësisht e mbrojnë mjedisin jetësor dhe vlerat e komunitetit.

Potenciali _____		

Hapi 10: Përkufizimi i potencialeve prioritare dhe zgjidhjet

Objektivi: Përmes kontrollit të kriterëve të qëndrueshmërisë dhe opsioneve me efekte pozitive mbi mjedisin jetësor dhe mbi zhvillimin, që shkojnë në favor të palëve të interesuara dhe aktiviteteve të cilat në afat të shkurtër japin rezultate të dukshme, të përcaktohen potencialet, mundësitë dhe politikat më të preferuara të cilat premtojnë më shumë.

Tipi i efektit të pritshëm dhe sinergjia potenciale	Opsioni/ aktiviteti 1	Opsioni / aktiviteti 2	Opsioni / aktiviteti 3
Për qëllimet e qëndrueshmërisë	Për shembull, ruajtja e natyrës (shumë i qëndrueshëm).	Për shembull, edukimi dhe hulumtimi.	Për shembull, riparimi i urës së vjetër dhe mullirit (i qëndrueshëm).

Për realizimin teknik		Shtigjet dhe panelet (lehtësisht të realizueshëm).	Ndihmë për urën dhe mullirin (kur është e nevojshme, ekspertiza mund të fitohet).
Për arsyetimin e shpenzimeve		Përfshihen firmat lokale (investime të vogla për firmat, të cilat do të kenë fitim nga realizimet).	Përfitim nga turizmi (restorantet, suvenirët, parkingjet), realizim i të ardhurave.
Për lidhjen me nevojat shoqërore zhvillimore	Vende pune për banorët lokal (mbulohet nevoja për të ardhura).	Ndërgjegjësim i shtuar, informim dhe njohuri për shfrytëzimin përkatës dhe të dobishëm të resurseve.	Ndikimi mbi njerëzit me arsim të lartë, kushte adekuate për njerëzit me kërkesa më të mëdha.

Shembull (nga Vevçani, i transponuar në gjuhën angleze):

Overview of the working groups with info on the meetings held so far

WG 1: Vevçani Springs Participants of the WG: Popeski Krste , Popeski Angelko, Batkoska Liljana, Leshoski Simun, Kostojcinoski Jovan, Radinoski Vasil				
Meeting No.	Participants	Facilitator	Step of the GA process	Outcome
1	Popeski Krste Popeski Angelko -Batkoska Liljana -Leshoski Simun - Kostojcinoski Jovan -Radinoski Vasil	Markovska Maja	Trends	Defining the trends that influence the Values in the community. Trends concerning the Vevçani Springs complex. Increased No of tourists in the springs in the past 5 years Erosion of the land in the springs/ decreased security of the springs Degradation of the infrastructure in the springs Increased No of water users in Vevçani Increased quality of the drinking water in the past 5 years Decreased water usage for agriculture/ land watering
2	Popeski Krste Popeski Angelko -Batkoska Liljana -Leshoski Simun - Kostojcinoski Jovan	Markovska Maja	Trends/ research	Gathering documents and information for the trends listed in the previous meeting. Contacts with the health department in Vevçani, gathering info from the elders in the municipality. The Municipality of Vevçani does not have official info and statistics to release for the Springs condition and the No of tourists that visit Vevçani and the springs. The Increased No of tourists is calculated by combining the info gathered from the local restaurants and the obligatory visits of the springs by primary and secondary schools in Macedonia.
3	Popeski Krste Popeski Angelko -Batkoska Liljana -Leshoski Simun - Kostojcinoski Jovan	Markovska Maja	Impacts	Impacts of the trends on the Value- Vevçani springs Dividing the impacts of the trends in two groups : Positive and Negative impact Several of the trends had positive and negative impact in the same time over the value.
				<table border="1"> <thead> <tr> <th>Positive</th> <th>Negative</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Increased No of tourists in the springs in the past 5 years (positive for the economy in the municipality and promotion)</td> <td>Increased No of tourists in the springs in the past 5 years (negative for the environment and the infrastructure of the springs)</td> </tr> </tbody> </table>
Positive	Negative			
Increased No of tourists in the springs in the past 5 years (positive for the economy in the municipality and promotion)	Increased No of tourists in the springs in the past 5 years (negative for the environment and the infrastructure of the springs)			

				Increased quality of the drinking water in the past 5 years	Erosion of the land in the springs/ decreased security of the springs
				Decreased water usage for agriculture/ land watering	Increased No of water users in Vevcani
					Degradation of the infrastructure in the springs
4	Popeski Krste Popeski Angelko -Batkoska Liljana -Leshoski Simun - Kostojcinoski Jovan	Markovska Maja	Vision and minimum standards	Sustainable eco-complex with defined tourist offer and promoted as eco resort with developed spa offer. Minimum standards for the springs: Minimum once a week the public waste enterprise collects waste from the springs. The quality of the water has to be remained up to 1(first) category of clean drinkable water. Minimum 30 visitors per month in the springs Minimum 2 cultural, traditional events held in the springs	
5	Popeski Krste Popeski Angelko -Batkoska Liljana -Leshoski Simun	Markovska Maja	Problems/analysis	- Not controlled movement of tourists in the springs No guards in the springs Vevcani does not have licensed tourist guides No management strategy for the springs Destroying the flora and fauna in the springs No generated income to maintain the springs	
6/7	Popeski Krste Popeski Angelko - Kostojcinoski Jovan -Radinoski Vasil	Markovska Maja	Problems/Potentials	Spreading the territory of the springs by building new hiking trails – will increase the offer of the springs Creating plan and strategy to manage the springs Promoting the springs Creating a fund for guarding service in the springs	
8/9/10	Kuskoski Goko, Kostojcinoski Marjan, Popeski Krste, Batkoska Liljana, Mukoski Ljupco	Maja Markovska	Drafting the document	Completing the document by merging the documents from the 3 working groups and creating action plan.	

Shembull (nga Manastiri):



RAPORT NGA MBLEDHJA ME GRUPIN E PUNËS PËR EKO-QENDËR (7)

Hapi 10: Përkufizimi i potencialeve prioritare dhe zgjidhjet

Më datë 09.10.2008, në ora 19:00, u mbajt mbledhja me Grupin e punës për Eko-qendrën „VOLVOKS“, në të cilën morën pjesë anëtarët e këtij grupi punues.

Në mbledhje u diskutua në lidhje me përkufizimin e potencialeve prioritare dhe zgjidhjet.

Nga diskutimet ka rezultuar tabela si vijon:
Qendra informative–edukative „VOLVOKS“

Realizimi teknik:	<ul style="list-style-type: none">- sipas planit të përpiluar hapësinor nga arkitekti, realizimi teknik është i mundshëm dhe realisht i zbatueshëm;- aktivitetet e deritanishme të Grupit të punës (zgjerimi i rrugës për hyrje-dalje, rregullimi i tokës, përpilimi i metodologjisë për punë) na japin të drejtë dhe na inkurajojnë në drejtim të realizimit teknik.
Arsyetimi i shpenzimeve:	<ul style="list-style-type: none">-me zhvillimin e përmbajtjeve të „Volvoks“-it do të zhvillohen edhe metodat e punës së qëndrueshme financiare;-interesimi i komunës së Manastirit, përmes ndërmarrjeve publike me mekanizim dhe ndihmë tjetër, na inkurajon që të vazhdojmë me zbatimin e idesë.
Lidhja me nevojat zhvillimore shoqërore	-funksionimi i Qendrës informative-edukative për zhvillim të qëndrueshëm do të gjenerojë ndryshime pozitive, mundësi për punësime dhe vetëpunësime, ndërgjegjësimit dhe informim më të lartë.

Në mbledhje morën pjesë:

Aleksandra Stojanovska, prof. Hristo Dimitrovski, Toni Stojanovski, Meri Bandevska, Dimitar Egumenovski, Bllagoçe Çamurovski, Toni Stojçevski, Darko Jovanovski, Katerina Trajkovska.

Shembull (nga Manastiri):



RAPORT NGA MBLEDHJA ME GRUPIN E PUNËS PËR EKO-TURIZËM (7)

Hapi 10: Përkufizimi i potencialeve prioritare dhe zgjidhjet

Më datë 07.10.2008, në ora 18:00, u mbajt mbledhja me Grupin e punës për zhvillimin e eko-turizmit, në të cilën morën pjesë anëtarët e këtij grupi punues.

Në mbledhje u diskutua për përcaktimin e potencialeve prioritare dhe zgjidhjet. Pas një diskutimi më të gjatë u miratua konkluzioni se si prioritet do të merret zhvillimi i Famullisë Ahishte dhe përpjekjet për ringjalljen e fshatit Oreov, si dhe krijimin e shtegut i cili do ta lidh Eko-qendrën dhe kishat e manastiret në Famullinë Ahishte.

Shtigje urbane për qarkullim: Park të qytetit – Tumbe kafe – lokaliteti antik “Heraklea” – “Treshja e Shenjtë”.

Realizimi teknik:	- Nevojitet vendosja e udhërrëfyesve, rregullimi i shtigjeve për këmbësorë dhe vendosja e infrastrukturës së nevojshme (kosha plehrash dhe stole); - ideja u është prezantuar edhe autoriteteve lokale, të cilët i kanë dhënë mbështetje kësaj nisme.
Arsyetimi i shpenzimeve:	- Sipas vlerësimeve nevojiten rreth 2000 euro për realizimin e këtij projekti.
Lidhja me nevojat zhvillimore shoqërore:	- mënyra bashkëkohore e jetesës i ndryshoi edhe shprehitë e njerëzve; atë që ne dëshirojmë ta promovojmë është kthimi i shprehive për shëtitje në natyrë, shëtitje me biçikletë, piknik dhe ngjashëm.

Në mbledhje morën pjesë:

- Neshat Azemovski,
- Romeo Micevski,
- Zoran Rizovski,
- Katerina Mavrovska,
- Natasha Ginova,
- Aleksandra Pandovska,
- Lubo Trifunovski,
- Todor Ivanovski,
- Meri Bandevska,
- Katerina Trajkovska.

Shembull (nga Manastiri):



RAPORT NGA MBLEDHJA ME GRUPIN E PUNËS PËR UJË (7)

Hapi 10: Përkufizimi i potencialeve prioritare dhe zgjidhjet

Më datë 08.10.2008, në ora 19:00, u mbajt mbledhja me Grupin e punës për mbrojtjen e ujërave. Në mbledhje morën pjesë anëtarët e këtij grupi punues.

Temë e diskutimit ishte përkufizimi i potencialeve prioritare dhe zgjidhjet. Fushata për kursimin e ujit dhe mbrojtjen e resurseve të ujit.

Realizimi teknik:	Fushata do të përbëhej nga 3 elemente: 1. Edukativ (në bashkëpunim me shkollat fillore dhe të mesme). 2. Mediatik (në bashkëpunim me autoritetet lokale). 3. Organizim të ngjarjeve speciale (pastrimin e shtratit të lumit dhe ngjashëm). Në bashkëpunim me autoritetet lokale dhe ndërmarrjet publike, të cilat posedojnë mekanizim, fushata nga aspekti teknik është e realizueshme.
Arsyetimi i shpenzimeve:	Nuk ka analizë precize.
Lidhja me nevojat zhvillimore shoqërore:	Uji është një resurs jashtëzakonisht i rëndësishëm nga aspekti i ekzistencës së njeriut, por edhe nga aspekti sanitar dhe higjienik, si dhe nga aspekti i rëndësisë për industrinë dhe bujqësinë.

Në mbledhjen morën pjesë:

- Ruzha Petrova,
- Maria Petkovska,
- Alekdandra Stojanovska,
- Juliana Strezovska,
- Remzi Medik,
- Neshat Azemovski,
- Dragan Jankoski,
- Dimitar Egumenovski.

Shembuj (nga Dellçeva, të dhënë në formë integrale):

Prioritetet e "Axhendës së Gjelbër" në Dellçevë

Grupi i punës për kulturë dhe trashëgimi kulturore

- Përcaktimi i monumenteve të kulturës në Komunën e Dellçevës.
- Ndërtimi i parkut edukativ për fëmijë dhe trim-shtigje tek liqeni Petrashevec, afër Dellçevës.
- Përcaktimi i objekteve fetare në Komunën e Dellçevës.
- Përcaktimi i lokaliteteve arkeologjike dhe paleontologjike në Komunën e Dellçevës.
- Ndërtimi i bilbordeve dhe materialit propagandistik për monumentet e kulturës, objektet fetare dhe lokalitetet arkeologjike e paleontologjike.
- Vendosja e udhërrëfyesve dhe tabelave informative për monumentet e kulturës dhe trashëgimisë kulturore.
- Rregullimi i pikave për piknik me ndriçim, stole, veranda, kosha plehrash, dhe shtigje të aksesshme.
- Vënia në funksion e muzeut dhe ruajtja e artefakteve dhe mbetjeve të fosileve të gjetura në muzeun e komunës.
- Fushata për masivizimin e manifestimeve tradicionale kulturore.

Nga aktivitetet e deritanishme të "Axhendës së Gjelbër" është lidhur Marrëveshje për financimin e një pjese të këtyre nevojave të identifikuara me "Pro Kredit Bankën" edhe atë për vendosjen e 10 stolave në Parkun e qytetit dhe vendosjen e 2 bilbordeve në qendrën e qytetit, për të gjitha monumentet e rëndësishme të kulturës, objektet fetare dhe lokalitetet arkeologjike e paleontologjike.

Prioritetet e "Axhendës së Gjelbër" në Dellçevë

Grupi i punës për turizëm

- Rregullimi i pikave për piknik: Petrashevc, Hendeku i Manastirit, Golak dhe Kukuljeto (monument natyror në fsh. Istevnik).
- Përpilimi i cicëronit turistik dygjuhësor (maqedonisht-anglisht) me kapacitete akomodimi me kartë dhe informacione.
- Trajnimi i punëtorëve të hotelierisë dhe sidomos ata që ofrojnë akomodim privat.

- Përfundimi i ETNO-PARKUT në fshatin Grad të Dellçevës (50% është ndërtuar) dhe vënien e tij në funksion të turizmit.
- Ndërtimi i objektit efikas energjetik, i cili do të përdoret për trajnim dhe edukim të popullatës dhe i njëjti do të vihet në funksion të ofertës turistike.
- Krijimi i kushteve për shfrytëzimin e potencialeve për zhvillimin e turizmit.
- Hulumtime në lidhje me mundësitë për zhvillimin e turizmit në zonën e Pijanecit.
- Krijimi i kushteve për transformimin e lokalitetit Golak në qendër të zhvilluar dhe emblematike turistike.
- Krijimi i kushteve për zhvillimin e turizmit kulturor rural dhe turizmit transitor.
- Rregullimi infrastrukturor i lokaliteteve turistike.
- Kapacitetet ekzistuese.

Turizmi

Kapacitetet akomoduese:

A) Hotel "Maqedonia";

Rr. "Mareshali Tito"

Tel: 033/411-714

Kapaciteti: 70 shtretër.

B) Motel "Kulla";

Kapaciteti: 3 apartamente.

C) Vila "Granit" - Golak;

Kapaciteti: 20 shtretër.

Ç) Vikend shtëpiza në Golak.

D) Shtëpi private.

Prioritetet e “Axfordës së Gelbër” në Dellçevë

Grupi i punës për ujë

- Përfundimi i sistemit të kolektorit të lumenjve: Bregallnicë, Gabrovçicë dhe Xvegorska.
- Rregullimi i shtretërve të të tre lumenjve: Bregallnicë, Gabrovçicë dhe Xvegorska.
- Vendosja e argjinaturës prej gome në zonën qendrore të qytetit me kapacitet më të madh (aktualisht ekziston) me qëllim të ruajtjes së florës dhe fondit shtazor në periudhat kritike kur lumi zvogëlohet ose shteret.
- Përmirësimi i cilësisë së ujit për pije me zëvendësimin e tubave ekzistuese nga çimentoja dhe azbesti, të cilat për nga përbërja janë kancerogjene dhe të rrezikshme për jetën e qytetarëve.
- Mbrojtja e çezmave të vjetra natyrore, burimeve dhe gurrave në komunë, përmes rikonstruksionit të tyre dhe me marrjen e rregullt të mostrave të ujit me qëllim të analizave kimike dhe bakteriologjike.
- Rikonstruksioni i shatërvanëve ekzistues për ujë të pijshëm dhe ndërtimi i të rinjve.

Prioritetet e “Axfordës së Gjëlber” në

Dellçevë

Grupi i punës për mjedis të pastër

- Zëvendësimi i dritave me zhivë me drita më efikase energjetike, të cilat do të kontribuojnë në reduktimin e emisionit të CO2 dhe për ndriçim më efikas dhe zvogëlimin e shpenzimeve për ndriçim.
- Pastrimi i plehërishtave informale.
- Zëvendësimi i zgjidhjeve ekzistuese për grumbullimin e mbeturinave me masa të cilat do të kontribuojnë për ngritjen e nivelit të higjienës në qytet, përkatësisht do të parashikohet riciklimi i mbeturinave.

- Organizimi i aksioneve për pyllëzim dhe gjelbërimin e sipërfaqeve të zhveshura.
- Edukim në fushën e efikasitetit energjetik.
- Pastrimi i shtretërve të lumenjve në komunë me qëllim që të zvogëlohet mundësia e vërshimeve.



Rezultati i zëvendësimit të dritave efikase energjetike me kandellabra në qendër të Durrësit



FAZA 4: SINTEZA DHE PLANIFIKIMI

Objektivi: Të përkufizohet vizioni dhe orientimi strategjik i “Axfordës së Gjellbër”. I përfshin hapat: prej 11 deri 13.

Aktivitetet:

Përgatitja dhe mbajtja e punëtorive për prezantimin e rezultateve të përkohshme të grupit më të gjerë.

Konsultime me ekspertë.

Punëtori me prezantimin e rezultateve të mëtuqeshme, informatave kthyesë dhe informatave plotësuesë.

Përmbyllja e punës së grupeve të punës.

Marrëveshje për orientim strategjik.

Palët e interesuara merren vesh se kush çka do të punojë.

Përpilimi i draft dokumentit “Axforda e Gjellbër”.

Këtu përfundojnë mbledhjet e rregullta me grupet e punës. Në periudhën në vazhdim grupet e punës duhet të merren me realizimin e aktiviteteve prioritare dhe të punojnë në përforcimin e kapaciteteve të grupit për realizimin e të njëjtëve. Në këtë fazë prioritet i grupeve të punës është implementimi i pilot-projekteve në komunitet, të cilët shërbejnë për të arritur deri te zgjidhjet e shpejta, momentale dhe të dukshme të aksioneve urgjente. Me realizimin e pilot-aksioneve do të rritet motivacioni i anëtarëve të grupeve të punës që ta vazhdojnë punën e tyre dhe njëkohësisht edhe ata vet të krijojnë rezultate të dukshme nga puna paraprake.

Pilot-aksionet duhet të jenë të dukshme për tërë komunitetin dhe të paraqesin të mirë të përgjithshme.



Rezultat nga pilot-projekti në Vevčan-vrojtore në Burimet e Vevčanit

ПАТЕКА КОН СВ.СПАС	
ПАТЕКА КОН ВЕВЧАНСКИ ЕЗЕРА - ЛОКВИ	
ПАТЕКА КОН ЦРКВИ КЛАДЕНЕЦ	
ПАТЕКА КОН ЈАНКОВ КАМЕН	
ОЗНАЧЕНИ ПАТЕКИ	
	<p>Цркви Кладенец се наоѓа на 1800 м надморска височина. Местото го добиле ова име заради бојата на каменето корито и лиијата од дрвјата кои го опкружуваат. Во најголем дел патот до него е асфалтиран, а остатокот е тампонски пат.</p>
	<p>Јанков Камен се наоѓа на 1200 м надморска височина. До ова илестичко место води асфалтиран пат. Илестичкиот комплекс располага со планинска куќичка, маса и клупи на отворено, како и десеттина скари кои се на располагање на илестичките.</p>
	<p>Вевчанските локви се глацијални езера кои се наоѓаат на 2000 м надморска височина. Во ладната и бистра вода егзистира ендемично-приметлива животинска форма, а опкружувањето е нечовечко од страна на човекот.</p>
	<p>Вевчанската голмина се наоѓа на 2078 м надморска височина. Местото е од посебна важност за вевчанци, бидејќи се верува дека на тоа место престојувал Светиот Апостол Павле, за време на својата мисија во Македонија. Секоја година на Петровден вевчанци масовно ја посетуваат Голмина.</p>
	<p>Црквата Св. Спас се наоѓа на 1310 м надморска височина, од центарот на Вевчани е оддалечена на околу 50 минути пешачење. Од дворот на црквата се протега прекрасен пејзаж на Вевчани и на струшката котлина. До црквата води трансран, асфалтиран пат.</p>

HAPI 11 DHE 12: PËRKUFIZIMI I PLANIT STRATEGJIK NË KUADËR TË DOKUMENTIT “AXHENDA E GJELBËR”

Objektivi: Zhvillimi i planit strategjik në bazë të këqyrjes së problemeve kryesore, potencialet, mundësitë dhe zgjidhjet e arritura në hapat paraprak. Përpilimi i pilot-projektit të vogël i cili komunitetit mund t'i prezantojë rezultate të dukshme, konkrete dhe joshëse. Këto pilot-projekte janë mënyrë për ruajtjen e nivelit të inkuadrimin dhe motivimit të njerëzve dhe gjithësesi për arritjen e rezultateve.

Varësisht nga analizat paraprakisht të bëra dhe nga të dhënat e grumbulluara, duhet të përpilohet plani strategjik në dokumentin “Akhenda e Gjelbër”. Mos harroni se po ky dokument duhet të shqyrtohet dhe miratohet nga Këshilli komunal.

Plani strategjik i dokumentit “Akhenda e Gjelbër” paraqet urë e cila do t’ju ndihmojë për të arritur nga gjendja e tanishme në gjendjen e dëshiruar të komunitetit – Realizim i vizionit të cilin e përcaktuat në hapat paraprak të planifikimit.

Që të fillohet me përpilimin e dokumentit “Akhenda e Gjelbër”, duhet të organizohet puna dhe të grumbullohen të gjitha dokumentet, procesverbalet, raportet dhe analizat nga të gjitha grupet e punës. Në këtë fazë punën e bartin koordinatorët e projektit dhe koordinatorët e grupeve të punës, të cilët kanë më shumë përvojë në punën e deritanishme.

Nëse faza paraprake përbëhet nga analizat dhe hulumtimet, kjo fazë paraqet sintezë të punës të të gjitha grupeve të punës dhe përpilim të dokumentit, i cili do ta përmbajë punën dhe planin në tërësi.

Nëse mënyrën dhe metodën e planifikimit strategjik nuk e njihni mund të angazhoni trajnerë që t’ju ndihmojnë për ta përpiluar dokumentin në tërësi dhe të njëjtin ta prezantoni dhe t’ia dërgoni Këshillit komunal.

Faza e sintezës është përgatitja e draft-versionit të dokumentit dhe mund të zgjasë një periudhë më të gjatë, varësisht nga përgatitja juaj dhe nga vëllimi i materialit që duhet ta përpunoni.

Ky hap duhet të përfundojë me draft-versionin e dokumentit “Akhenda e Gjelbër”.



Rezultati nga pilot-projekti në manastir: Qendra informative-edukative “VOLVOKS”



HAPI 13: PËRPILIMI I DOKUMENTIT

Objektivi: Dokumenti final “Akhenda e Gjellbër”.

Përshkrimi: Ky hap është vazhdim i hapit paraprak dhe përbëhet nga prezantimi i draft-versionit të tij para:

- anëtarëve të grupeve të punës;
- ekspertëve;
- këshilltarëve të Këshillit komunal;
- kryetarit të komunës;
- debatit publik në komunitet.

Varësisht nga madhësia e komunitetit do të zgjidhni metodë përkatëse për prezantimin e draft-versionit të dokumentit.

Në takimet për promovimin e dokumentit është me rëndësi që të mos orvateni që të pranishmëve t’u jepni sqarime se përse ky dokument është pikërisht i këtillë dhe ta mbroni atë që e keni përpiluar, por me vëmendje t’i dëgjoni të gjithë dhe t’i regjistroni të gjitha komentet, kritikën, lëvdatat dhe sugjerimet për ndryshimin e pjesëve të dokumentit. Megjithatë, ky është një dokument të cilin e përpilon komuniteti në tërësi dhe i njëjti duhet të korrespondojë me opinionet, nevojat dhe kërkesat e tij.

Nevojitet të bëhet një prezantim i veçantë i dokumentit para grupeve të punës dhe t’i dëgjoni opinionet dhe vërejtjet.

Pas promovimit të dokumentit, në versionin e parë të punës, duhet t’i shqyrtoni të gjitha sugjerimet, vërejtjet dhe propozimet dhe ta shihni mundësinë e inkorporimit të tyre në dokument, për ta kompletuar, tanimë si dokument të plotë final të emërtuar “Akhenda e Gjellbër”.

Tekstin e dokumentit dhe përmbajtjen e të njëjtit duhet ta përpilojë një person me qëllim që të ruhet mënyra dhe stili i të shkruarit.

Pasi t’i keni kaluar të gjitha këto faza, dokumenti juaj “Akhenda e Gjellbër” është i gatshëm për në seancën e Këshillit komunal.

Me kërkesën Tuaj mund tua dërgojmë dokumentin nga të tri komunat në Maqedoni, të cilat në periudhën kohore prej vitit 2007-2010 e zbatuan procesin e “Akhendës së Gjellbër”.

FAZA 5: MBIKËQYRJA (MONITORIMI) DHE VAZHDIMI

Objektivi: Të zhvillohet dhe të administrohet me sistemin e monitorimit në mënyrë që të vlerësohet progresi në realizimin e prioriteteve të “Axhendës së Gjelbër”.

Aktivitetet përfshijnë:

- zhvillimin e Planit për monitorim;
- zbatimin e Planit për monitorim dhe njoftimin e komunitetit dhe të të gjithëve që bashkëpunojnë ngushtë në procesin e “Axhendës së Gjelbër”.

Të sajohen aktivitete që do të vijojnë pas përfundimit/miratimit të dokumentit dhe realizimit të pilot-projektit, të cilët do të mund ta vazhdojnë zbatimin e suksesshëm dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të procesit “Axhenda e Gjelbër”.

Në këtë drejtim, pasi të përfundojnë të gjitha fazat, duhet të mendohet për statusin e grupeve të punës. Duhet ta gjeni dhe zbatoni mënyrën më të mirë transformimit të grupit të punës dhe nëse kjo ndodh do të mund të orientoheni drejt realizimit të të gjitha prioriteteve të “Axhendës së Gjelbër” dhe do të keni mundësi që dokumentin ta zbatoni në tërësi.

Në komunat në të cilat tani më është zbatuar “Axhenda e Gjelbër” grupet e punës u transformuan në shoqata të qytetarëve, të cilët vazhduan me punë në realizimin e projektit të dokumenteve të komuniteteve të tyre. Në këtë mënyrë do ta përforconi sektorin civil brenda komunitetit dhe do ta mundësoni vazhdimësinë e “Axhendës së Gjelbër” si proces ciklik, i cili jep rezultate të mira dhe pozitive për komunitetin në tërësi.

NDËRLIDHJA E “AXHENDËS SË GJELBËR” ME LEGJISLACIONIN E MAQEDONISË

Ç’është AXHENDA LOKALE 21?

- “Akhenda Lokale 21” është koncept që u zhvillua në Konferencën e KB-së për mjedisin jetësor dhe zhvillim (UNCED), që u mbajt në Rio de Janeiro në vitin 1992
- “Akhendën Lokale 21” e miratuan mbi 178 qeveri

Si ndërlidhet “Akhenda Lokale 21” me “Akhendën e Gjelbër”?

- Autoritetet lokale i ndërtojnë, administrojnë dhe mirëmbajnë infrastrukturën ekonomike, sociale dhe ekologjike, i monitorojnë proceset e planifikimit, instalimit të politikave dhe rregullave ekologjike lokale dhe e ndihmojnë zbatimin e politikave dhe normave nacionale nga fusha e mjedisit jetësor.
- Ideja buron nga Axhenda 21, por “AGJ” kryesisht përqendrohet në probleme ekologjike/probleme nga fusha e mjedisit jetësor dhe për zgjidhjet e të njëjtave, dhe më pak për çështje ekonomike dhe sociale.
- Mënyra participative e përbaljes me problemet dhe zgjidhjet lokale, mundësitë dhe kërcënimet, me qëllim që t’i përmirësojnë kushtet e jetesës.
- Proces transparent në të cilin të gjithë qytetarët kanë të drejtë të barabartë për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes duke synuar drejt mbrojtjes më të mirë të mjedisit jetësor;
- “Akhenda e Gjelbër” e inkurajon bashkëpunimin dhe partneritetin ndërmjet të gjitha grupeve sociale brenda komunitetit lokal.

Si ndërlidhet “PVEL me “Akhendën e Gjelbër”?

- PVEL ose Plan Veprimi Ekologjik Lokal paraqet obligim ligjor të pushtetit lokal (Neni 62 i Ligjit për mjedisin jetësor nga data 22.06.2005).
- Procesi i “Akhendës së Gjelbër” në aspektin territorial nuk kufizohet në një komunë ose vendbanim.
- Qasja pozitive, e cila nuk fillon me përcaktimin e problemit por me përcaktimin e vlerave dhe mbrojtjen e avancimin e tyre.

- “Akhenda e Gjellbër” ofron aktivitete dhe rezultate të dukshme për një kohë shumë të shkurtër.
- Për shembull në Serbi – disa komuna fill pas miratimit të PVEL-së kanë paraqitur kërkesë për përpilimin e “AGJ”.
- Propozim: Revidimi i PVEL-së përmes procesi të “Akhendës së Gjellbër” në të gjitha komunat e Maqedonisë.

KONVENTA E ARHUSIT

- Konventa e Arhusit, ratifikuar më 1999, e rregullon qasjen deri te informatat nga fusha e mjedisit jetësor, pjesëmarrjen në vendimmarrje dhe qasjen deri te drejtësia në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor.
- Pjesëmarrja e publikut gjatë përgatitjes së planeve dhe programeve të cilat kanë të bëjnë me mjedisin jetësor, në një kornizë transparente dhe të drejtë, duke i siguruar informatat e domosdoshme për publikun.
- Pjesëmarrja maksimale e publikut është faktor kryesor i “Akhendës së Gjellbër”.

PLANI HAPËSINOR I RM-së (2002-2020)

- “Në mbrojtje të vlerave natyrore dhe kulturore dhe angazhimeve për avancimin e cilësisë së të jetuarit në Republikë rëndësi të veçantë kanë mbrojtja dhe promovimi i begatave të vlefshme natyrore dhe zonave më të mëdha me dedikim të veçantë dhe me vlera natyrore të rëndësishme për bio-diversitetin dhe cilësinë e mjedisit jetësor, si dhe mbrojtja dhe promovimi ose trajtimi adekuat i pasurisë kulturore konform rëndësisë dhe domethënies kulturore e civilizuese” (ekstrakt).

LIGJI PËR VETADMINISTRIM LOKAL

(Gazeta zyrtare e RM-së nr. 5 nga data 29.01.2002)

- Mbrojtja e mjedisit jetësor dhe e natyrës-masa mbrojtëse dhe parandaluese nga ndotja e ujit, ajrit, tokës, mbrojtja e natyrës, mbrojtja nga zhurma dhe rrezatimit jonizues (Neni 22).
- Kultura – mbështetja institucionale dhe financiare e institucioneve dhe projekteve kulturore; kultivimi i folklorit, zakoneve, zejeve të vjetra dhe vlerave të ngjashme kulturore; organizimi i manifestimeve kulturore; nxitja e formave të ndryshme specifike të krijimtarisë (Neni 22).

- Qytetarët, në mënyrë të drejtpërdrejt marrin pjesë në vendimmarrje për çështje që kanë të bëjnë me rëndësinë lokale përmes nismave qytetare, tubimit të qytetarëve dhe referendumit, në mënyrë dhe procedurë të përcaktuar me ligj (Neni 25).
- Mund të perceptohet në implementimin e konceptit të “Axfordës së Gjellbër”.

ZHEL- Strategjia për Zhvillimin Ekonomik Lokal

- “Dokument strategjik i afirmuar”.
- Përqendrohet në zhvillimin ekonomik lokal përmes inkorporimit të parimeve për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor.
- Duhet të sigurohet pjesëmarrje e publikut përmes grupeve të punës në krijimin e dokumentit.
- Tërë procesi shfrytëzon metodë të ngjashme me “Axfordën e Gjellbër”.

LIGJI PËR MJEDISIN JETËSOR (Gazeta zyrtare e RM-së nga data 22.06.2005)

- OASH kompetent për punët nga fusha e mjedisit jetësor siguron mbështetje të projektit për mbrojtjen e mjedisit jetësor përmes programit vjetor për investime në mjedisin jetësor (Neni 172).
- Konkurs për shpërndarjen e mjeteve për financimin dhe realizimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve të tjera nga fusha e mjedisit jetësor për vitin 2010, shpallur në Gazetën zyrtare të RM-së nr. 27/2010, nga data 24.02.2010 të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.
- Sipas kësaj rezulton se në Maqedoni janë financuar 3 “Axforda të Gjellbra” të reja – Projekt me emërtimin “Axforda e Gjellbër si vegël për ruajtjen e vlerave natyrore”.

LIGJI PËR MBROTJEN E NATYRËS

(Gazeta zyrtare e RM-së nga data 15.09.2004)

- OASH kompetent për punët nga fusha e natyrës: zhvillimi dhe krijimi i politikës për mbrojtjen dhe avancimin e diversitetit biologjik, diversitetit zonal dhe trashëgimisë natyrore shpall zona të mbrojtura, monumente të natyrës.
- Kompetentët “punojnë” në favor të procesit të “Axfordës së Gjellbër”.

LIGJI PËR MBROJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE

(Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 20/04)

- Ministria e Kulturës, shoqatave të qytetarëve nga fusha e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, tua besojë kryerjen e autorizimeve publike si vijon (Neni 157).
- Disa punë të caktuara në lidhje me ruajtjen dhe mirëmbajtjen e trashëgimisë kulturore të paluajtshme në pronë shtetërore me të cilën administron;
- Organizimin e tribunave publike gjatë përgatitjes së ligjeve dhe normave të tjera për trashëgiminë kulturore, nga kompetenca e saj;
- Zhvillimin e metodologjive dhe mekanizmave të rinj, si dhe avancimin e sistemit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;
- Zhvillimin e projekteve me interes nacional për avancimin e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore;
- Përcaktimet dhe objektivat e përbashkëta në drejtim të mbrojtjes dhe avancimit të trashëgimisë kulturore.

STRATEGJIA NACIONALE PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM

- Zhvillimi i qëndrueshëm paraqet objektiv përfundimtar të Bashkëpunimit evropian në Bashkimin Evropian.
- Zhvillimi i qëndrueshëm paraqet proces permanent, i cili përfshin përmirësimin e integritetit të aspekteve ekonomike dhe sociale të mjedisit jetësor.
- Procese të pjesëmarrjes që të krijohen partneritete të cilat krahas shtetit do ta përfshijnë edhe sektorin privat dhe shoqërinë civile.